

Zoran Zaevi
20 qershori,
data e zgjidhjes
përfundimtare

Fq.3



**SEANCA
GJYQËSORE**
Vuloret
tentim-vrasja
ndaj Selës

Fq.5



Ishte koha
të largohem,
lojtarëve u
duhet një
ndryshim

Fq.22



Koha

www.koha.mk

**Kriza italiane
dhe ndikimi
në Evropë**

Fq.15

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3378 · E premte, 1 qershor 2018

15°C | 30°C

15 DEN

EDITORIAL

**Debati në
"mëhallën e
budallenjve"**



Shumë debatohet nëpër rrjetet sociale (amatorisht e më pak profesionalisht) mbi Lindjen dhe Perëndimin, mbi ithtarët dhe kritikuesit e Erdoganit, mbi Islamin dhe radikalizmin fetar dhe mbi shumë çka që më tepër është kompensim i punëve të mençura që nuk po i bëjnë shqiptarët, se sa debat që ka një përfundim dhe një zgjidhje. Hetohet një mosdurim, një diskreditim, ikje nga idetë dhe përqendrim te personat, mosgatishmëri për të ofruar argument dhe lehtësi për të baltosur atë që nuk e...

Fq.2

RAJON

**Dhunimet
në Kosovë
Daçiqi i quan
propagandë**

Fq.14

FORUM

**Vazhdon lufta
për ekzistencë
materiale**

Fq.11



ULJA E NATALITETIT, SHKAQET DHE PREVENTIVAT

MË PAK LINDJE, MË SHUMË MIGRIM



Dikur nënat lindnin më shumë fëmijë, edhe përkundër kushteve të vështira ekonomike e sociale. Por sot është ndryshe. Ekspertët detektojnë disa shkaqe që ndikojnë në rënien e lindshmërisë

Fq.7

Shqipja dhe drejtësia, dështimet e Qeverisë

Shkup, 31 maj - Në kuadër të njëvjetorit të Qeverisë, Aleanca për Shqiptarët e Zaidin Selës ka adresuar kritika të forta kundër kryeministrit Zaev dhe kabinetit të tij qeveritar. Fillimisht, zëdhënësi partiak Flakron Bexheti gjatë një konference për shtyp të mbajtur të enjten në Tetovë theksoi faktin se Qeveria Zaev nisi mirë reformat përderisa partia e tij ishte në Qeveri. "Qeveria LSDM-BDI, e cila e nisi rrugëtimin e

vetë si Qeveri Reformatore, nga qytetarët u prit e si Qeveri shpëtimi, që do siguronte kushte normale për jetë më të dinjitet, mbase edhe kishte një fillim të suksesshëm që premtonte ardhmëri më të mirë. Një fillim i mbarë, kur në qeverisje merre pjesë edhe Aleanca për Shqiptarët, ishte shpresëdhënës edhe për shqiptarët. Tani më, në rrumbullakimin e njëvjetorit të kësaj qeverisjeje, si



EDITORIAL

DEBATI NË "MËHALLËN
E BUDALLENJVE"

Emin AZEMI

Shumë debatohet nëpër rrjetet sociale (amatorisht e më pak profesionalisht) mbi Lindjen dhe Perëndimin, mbi ihtarët dhe kritikuesit e Erdoganit, mbi Islamin dhe radikalizmin fetar dhe mbi shumë çka që më tepër është kompensim i punëve të mençura që nuk po i bëjnë shqiptarët, se sa debat që ka një përfundim dhe një zgjidhje. Hetohet një mosdurim, një diskreditim, ikje nga idetë dhe përqendrim te personat, mosgatishmëri për të ofruar argument dhe lehtësi për të baltosur atë që nuk e njeh nga afër. Ka shumë inate të fshehura që komentuesit i paketojnë si "mendim ndryshe", por ka edhe shumë energji negative, si mungesë ventili për të debatuar me qytetari e respektim të tjetrit, edhe atëherë kur ai ka të drejtë.

Gjithmonë kur mendojmë se vetëm ne kemi të drejtë, edhe atëherë kur argumentet nuk janë në anën tonë, që në atë moment fillojmë të projektojmë një të "vërtetë virtuale" ku duhet edhe të tjerët patjetër të banojnë. Mirëpo këtu fillon keqkuptimi. Dhe më së paku jemi të vetëdijshëm se po gabojmë. Përkundrazi, i japim flakë pseudoargumentit tonë, duke i shpallur të gjithë të tjerët injorantë e harbutë.

Në këtë lëmsh komentimesh pa busull e kompas, ka edhe një ekstrem tjetër. Edhe atëherë kur dikush pajtohet me dikë për atë që e thotë, këtë e bënë thjeshtë nga kurtuazia ose nga parimi "mirë me të gjithë". Shpesh kjo kategori pajtohen me tjetrin, edhe atëherë kur intimisht mendon ndryshe. Shumë konformizëm, shumë demagogji.

Sa më shumë që debatohet lidhje e pa lidhje, më shpesh na kujtohet Umberto Eco i cili pat thënë se "mediat sociale u kanë dhënë të drejtën e fjalës budallenjve. Më përpara ata flisnin vetëm në bare pas një gote me verë, pa e dëmtuar komunitetin. Ua mbyllnin menjëherë gojën, ndërsa tani kanë të njëjtën të drejtë fjale me një fitues të çmimit Nobel". Për Econ, interneti është një dramë e vërtetë sepse promovon "budallain e fshatit si mbajtës të së vërtetës". Struktura e internetit, sipas tij, favorizon përhapjen e atyre që propagandojnë budallallëqe. Në këtë pikë, mendon Eco, roli i gazetave është shumë i rëndësishëm sepse "duhet të filtrojë me ekipe specialistësh informacionet që vijnë nga interneti sepse askush nga ne nuk është i aftë të kuptojë sot nëse një informacion është i besueshëm apo jo". Për të bërë këtë sipas tij "gazetat duhet tu dedikojnë të paktën dy faqe analizave dhe kritikave mbi përmbajtjet online, njëlloj si mësuesve u duhet tu mësojnë nxënësve si të përdorin të dhënat për të ndërtuar një çështje".

Hallë që sot kemi, nuk është si të përdorim internetin për të përvetësuar dijet që na mungojnë, por si i ta zbulojmë një mjet që do të na mbron nga budallallëqet e badihavxinjve të internetit. Në përpjekjet e lodhshme për të bërë këtë zbulim, sigurisht që do të shkojë edhe shumë kohë, ndërkohë që si preventivë mund të rrahën dy rrugë që na largojnë nga "mëhalla e budallenjve". Njëra - duke e mbyllur krejt Facebook-un, me çka iu përplasat para hundëve një "post bllok" gjithë atyre që kanë problem frustrimin ta zëvendësojnë me kulturën e komunikimit dhe e dyta - të injorosh totalisht lehtësi që bëhen në emër të komentimeve pa sens e pa karar. Si duket kjo rruga e dytë ngjan të jetë më produktive, por e kombinuar edhe më të parën, sipas nevojës. Kjo e fundit është "ilaç" për ofenduesit që fshatarësinë e trurit të tyre të vockël e shumëzojnë me lakminë për tu dukur si kuller në një qytet provincial.

Kultura e tolerancës nuk arrihet vetëm në Facebook. Ata që e posedojnë këtë kulturë para se të shpij Facebooku, kanë shanse të mira të krijojnë një ambient të favorshëm për komunikim normal, kurse të tjerët nuk do të arrijnë asnjëherë ta kuptojnë se teknologjia nuk është terapia më e përshtatshme që shëron komplekset e tyre.

ÇFARË KA MBI SAMAR?

"Qytetari nuk ha më 'bar', pa e kuptuar se çfarë ka mbi 'samar'!

1. Partitë politike kosovare, në vend që të ofrojnë POLITIKA ALTERNATIVE qeverisëse, po merren akoma me politikëbërje parazgjedhore....!
2. Qytetari, duhet t'i dënoj me armën e votës, herdo kur do të mbahen zgjedhjet (që paraprakisht duhet t'i paraprijë një Ligj i ri Zgjedhor) e radhës. Ndryshe, ndryshimi në qeverisje së bashku transicionin e procesit të shtendërtimit dhe demokratizimit të vendit, do zgjas me dekada të tëra...
3. E kontingjentet e reja në tregun e punës, nuk do të mund, dhe realisht nuk do e durojnë më këtë manipulim dhe "lojë" të bezdisshme e poshtëruese me ikonografinë e protagonizmave të ca liderucave injorant", shkruan në profilin e tij në Facebook, sociologu nga Kosova, Fadil Maloku.



SA KA DREJTËSI NË BOTË?!

"Nga 10 viktimat e trafikimit me njerëz 8 janë VAJZA. Në Botë ka rreth 781 milion njerëz që janë analfabetë. Dy të tretat (2/3) e tyre janë GRA. 62 milion VAJZA-ve nuk u lejohet shkollimi. Aktualisht, në 24 kompani të listuara në indeksin S&P 500 (Standard dhe Poor-së 500), vetëm 4,8 GRA mbajnë pozitën e KRYESHEFIT EGZEKUTIV të totalit. (S&P 500 është një indeks amerikan aksioneve të bazuar në kapitalizimin e tregut prej 500 ndërmarrjeve më të mëdha). Rreth 20% të gjithë deputetëve të parlamenteve në botë janë gra. Gratë prej moshës 15 deri 40 vjeç janë më shumë të rrezikuara nga PËRDHUNIMI dhe DHUNA në familje sesa rreziku i kancerit, lëndimeve në aksidentet rrugore, lufterat dhe malaria. EQUALPOËER/FUQIA E BARABARTË...", shkruan në profilin e saj në Facebook, aktivistja për të drejtat e grave, Gyner Basha Nebiu.



PAZARI I PLAKUT

"Na ishte një herë një propozim për emrin, sa për të i vënë në kurth disa të që fluturojnë me tallë (shkop misri... Ani sa e përkthyen edhe në tunguzisht edhe e përhapën se shqip është. Po jo vetëm disa të BDI-së, por edhe krejt VMRO-ja u ligavën.

Kapërcej edhe ai propozim, u dënua Gruevski. Krejt si një gripi vogël, tash po vazhdojmë bisedimet me të vjetrën. Ati ku e ka lanë plaki. Po kjo si puna e atij që i kishin ofru veprimtari me lek. tha jo. Kur i ofruan shumë lek, u mendua dhe tha OK atëherë. Pastaj ata ndërruan mendje i ofruan pak lek. Ky tha: unë a kontrabandist po ju dukem a?

- Sa për a je kontrabandist, u kuptuam po tash hajde të kshyrim pazarin!", shkruan në profilin e tij në Facebook, aktivisti nga Kumanova, Sead Ramadani.



MEDIACitate

S'ka dialog
teknik: Serbia
po kërkon
Asociacionin,
Kosova
energjinë

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj ka deklaruar se dialogu teknik është ndërprerë pasi Kosova si pikë të parë e kërkon zbatimin e marrëveshjes për energji, ndërsa, Serbia dhe evropianët, pikë të parë e kanë themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe.

Haradinaj duke iu kundërpërgjigjur deputetes së LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se pajtohet se nuk ka kuptim dialogu teknik nëse tema për energjinë nuk respektohet.

"Ne veç kemi arrit në këtë fazë fatkeqësisht, jo me vullneti tonë si Kosovë, ka një kohë që nuk po ndodhë dialogu teknik pikërisht për shkak të kësaj situate, ne e kemi konsideruar të padobishme me shkuar në tavolina ku nuk është pika e parë energjia, nuk refuzojmë tema tjera, por duhet të jetë kjo e para, në fakt pala serbe e ka riradhitë agjendën, e para është Asociacioni dhe për fat të keq edhe evropianët kështu po e konsiderojnë radhitjen, kemi ndërruar disa komunikime jo aq të këndshme me lehtësuesit e dialogut por jemi në pritje të rrjedhave të mëtejme dhe unë mendojë që parlamenti ka shumë të drejtë kur thotë që s'ka logjikë me u trajtuar temat me një radhitje kaq të gabuar dhe mos të trajtohen me seriozitetin e vet, çështja e energjisë", theksoi Haradinaj. Haradinaj është ndal edhe te pagesa e Qeverisë prej një milion për energjinë në veri, por nuk do të ndodhë në pafundësi, pasi sipas tij, zgjidhja do të jetë ose të arrihet marrëveshja ose Kosova të veprojë një anshëm të drejtën në treg.

(Koha Ditore, 31 maj)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

KUNDODHET NË SHQIPËRI KËSHTJELLA KLAUSURA E VITIT 1272?

Këlcyra e sotme është qyteza në rrethin e Përmetit përballë grykës së Këlcyrës, buzë bregut të djathtë të luginës së Vjosës. Por dikur ka qenë një pikë e rëndësishme kalimi, që përmendet në librat e historisë që në shek. IV-III para Krishtit. Rreth kësaj kohe në një kodër të malit të Trebeshinit, u ngrit kështjella e Këlcyrës me mure blloqesh guri drejtkëndësh. Fortifikimet u rindërtuan në mesjetën paraosmane. Përmendet për herë të

parë në dokumente të shkruara më 1272 me emrin Klausura. Rreth vitit 1335 përmendet kur e marrin kryengritësit arbëreshë. Në pjesën më të lartë të kodrës qenë edhe rrënojat e një kështjelle të periudhës së pushtimit osman. Në regjistrin osman të v. 1431 shënohet si qendër e vilajetit të Këlcyrës. Gjatë periudhës së Rilindjes Kombëtare, në këtë zonë, zhvilluan veprimtari patriotike një varg atdhetarësh.

"Grekët e Pavarur" kundër termit "Maqedonia"

Athinë, 31 maj - Partneri i koalicionit në Qeverinë greke, partia Grekët e Pavarur, nuk heq dorë nga qëndrimi i fuqishëm kundër emrit të përbërë dhe termit të përfshirë Maqedonia në emrin e vendit tonë. Këtë pozicion, edhe njëherë e konfirmuan anëtarët e partisë duke folur për mediat greke, njofton korrespondentja e MIA-s nga Athina. Zëvendësmministri i Bujqësisë, Vasilis Kokalis, zëdhënësja e partisë Madalena Papadopulu dhe nënkryetari i Parlamenti Dimitris Kokalis, të gjithë nga Grekët e Pavarur në tre intervista të ndryshme përsëritën se nuk e pranojnë termin Maqedonia në emrin e fqinjit. "Ne, Grekët e Pavarur, themi 'jo' për përdorim të emrit Maqedonia ose fjalë të nxjerra, ndërsa parakusht për çfarëdo lloj zgjidhje është revizion kushtetues, ndryshim i Kushtetutës, për shkak se nuk ekziston as përkatësi kombëtare maqedonase, as identitet maqedonas, as nuk ekziston gjuhë maqedonase dhe gjithsesi që zgjidhja të jetë erga omnes", tha zëdhënësja e partisë Madalena Papadopulu, duke folur për televizionin grek "Skaj". Ajo shprehu dozë rezerve lidhur me atë se nëse do të arrihet marrëveshje, duke thënë se "duhet të shohim se nëse Shkupi mund të pranojë revizion kushtetues dhe erga omnes që negociatat të mbërrijnë deri në zgjidhje". Zëvendësmministri i Zhvillimit Bujqësor, Vasilis Kokalis, në intervistë për televizionin grek "Skaj" tha se për disa ditë do të kuptohet nëse negociatat do të përfundojnë me marrëveshje, por edhe dërgoi kritika deri te pala e Maqedonisë. "Tre herë e shkelën marrëveshjen kohore në vitin 1995 dhe e shikoni se preferojnë emra që kanë qëllim irredentist, siç është Maqedonia Veriore, siç është Maqedonia e Epërme", tha Kokalis dhe shtoi se mbështetësit e emrit të përbërë, të cilët janë shumë nga partitë politike, por jo edhe shumica nga shoqëria greke, duhet t'i shpjegojnë popullit grek "se pse pala e Shkupit është e pa-kompromis". Njëri nga nënkryetarët e Parlamentit grek, Dimitris Kamenos, gjithashtu, nga radhët e Grekëve të Pavarur tha se partia e tij, në qoftë se në Parlament vjen emër pa termin Maqedonia, do të votojnë për, por në të kundërtën, mbeten në pozicionin e tyre. "Nëse nuk përfshihet emri Maqedonia, nëse duhet për shembull Republika Ballkanike Qendrore, gjithsesi se do të votojmë", tha Dimitris Kamenos.

SEANCË PARLAMENTARE PËR PYETJET E DEPUTETËVE

20 QERSHORI, DATA E ZGJIDHJES PËRFUNDIMTARE

Zaevi, duke iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve të VMRO-së, tha se propozimi "Republika e Maqedonisë së Ilindenit" së pari është refuzuar nga opozita greke dhe më pas - edhe nga opozita maqedonase, me çka është refuzuar si propozim nga pala greke. Në ndërkohë, ai përmendi datën 20 qershor kur do të tentohet të gjendet zgjidhje përfundimtare për çështjen e emrit

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 31 maj - Kryeministri Zoran Zaav gjatë seancës së rregullt mujore kushtuar pyetjeve të deputetëve, përmendi datën 20 qershor kur do të tentohet të gjendet zgjidhje përfundimtare për çështjen e emrit me Greqinë. "Jam i bindur se jemi rrugës për të gjetur zgjidhje. Gjasat janë shumë të mëdha të marrim datë me zgjidhjen e kontestit që zgjatë 25 vite. Deri më 20 qershor do të tentojmë të gjejmë zgjidhje", ka deklaruar Zoran Zaev. Deputetja e VMRO-DPMNE-së, Liljana Kuzmanovska, e pyeti kryeministrin se pse është refuzuar propozimi "Republika e Maqedonisë së Ilindenit", dhe nëse është e saktë se Qeveria në bisedime ka pranuar erga omnes për cilindo propozim në të ardhmen dhe nëse ka garanci se nëse pranojmë ndryshim të emrit, do të marrim datë për bisedimet.

"Që ta kumtojmë brenda, zgjidhjen 'Republika e Maqedonisë së Ilindenit' për të parën herë unë dhe kryeministri Cipras erdhëm në përfundim se duhet që e njëjta të bisedohet brenda shteteve. Do me thënë që deri aty jemi marrë vesh. Për fat të keq, opozita në Greqi nuk e pranoi dhe u refuzua dhe më pas u refuzuar edhe nga opozita e këtu-shme", tha Zaev. Për të pati pyetje nga deputetëve e VMRO-së se përse e mbante fshehur përbajtjen e letrës që Zaevi i ka dërguar Patriarkanës së Stambollit.

"Askush as nuk ka kërkuar dhe as që mundet ta ndërrojë emrin e Kishës Ortodokse të Maqedonisë. Nuk është temë e dilemave ose e debatit emri i KOM-it", potencoi Zaevi në seancën për parashtrimin e pyetjeve të deputetëve. Ai sqaroi se me letrën deri te Patriarkana ka



DIMITROV E INFORMON PËR BISEDIMET, IVANOVI NUK PRANON ERGA OMNES

Presidenti Gjorge Ivanov e priti ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov, me çka biseduan për ngjarjet e fundit rreth bisedimeve ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë rreth emrit. Në takimin, siç kumtoi kabineti i Ivanovit, Dimitrov me gojë e ka informuar shefin e shtetit për ngjarjet e fundit në lidhje me bisedimet për çështjen për dallimet rreth emrit, pa dorëzuar më parë kurrfarë dokumenti me shkrim. Presidenti Ivanov, shtohet në kumtesë, në takimin ka theksuar se "duke mos iu përbajtur përcaktimeve ligjore për nënshkrimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, i tërë procesi i ngjan



marrëveshjes personale ndërmjet dy kryeministrave". "I tërë procesi i ngjan marrëveshjes personale ndërmjet kryeministrin Zaev dhe kryeministrin Cipras, për çka nuk u siguria konsensus kombëtar në Republikën e Maqedonisë. Qëndrimi ynë është se nuk pranoj zgjidhje për çështjen e emrit për përdorim të përgjithshëm ose erga omnes", deklaroi presidenti i Maqedonisë në takimin. Ivanov potencoi se arritja e marrëveshjes ndërkombëtare duhet të jetë në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, e nuk parasheh ndryshim të tij.

kërkuar ndihmë, siç tha, rreth zgjidhjes përfundimtare të kontestit të kishës që ekziston nga ripërtëritja e Dioqezës së Kryepeshkopisë së Ohrit. Kryeministri Zaev tha se kabineti i tij sot do ta publikojë përbajtjen e letrës që nga ana e tij është dërguar deri te Patriarkana, si dhe përgjigjen prej atje.

"Kur janë pranuar kishat, janë pranuar si patriarkana. Dioqeza e Kryepeshkopisë së Ohrit dhe ngjashëm. Askush as nuk ka kërkuar dhe as që mundet ta ndërrojë emrin e Kishës Ortodokse të Maqedonisë. Nuk është temë e dilemës ose e debatit emri i KOM-it", tha kryeministri Zaev para deputetëve. Nga deputetët shqiptarë nga ora 11 kur filloi seanca e deri në orën 16 nuk pati pyetjeve të deputetëve. Më të zëshëm ishin deputetët e VMRO-së ndaj ministrit të Transportit dhe

SHUMICA KUNDËR NË REFERENDUMIN PËR EMRIN

Hulumtimet e mendimit publik sugjerojnë zgjidhje të pranueshme dhe më pak të pranueshme për emrin. Shumica e qytetarëve, ose 61.5 për qind do të votojnë kundër në referendum ku është parashtruar pyetja "A pajtoheni me ndryshim të emrit në Republika Ilinditase e Maqedonisë", thuhet në anketën e fundit të Agjencisë për hulumtime M-prospekt dhe Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtarë. 70.5% e maqedonasve do të votojnë kundër, ndërsa 52.8% e shqiptarëve e pranojnë emrin Republika Ilinditase e Maqedonisë. Sipas përkatësisë partiake, 92.7% nga VMRO-ja nuk e përkrahin propozimin, për simpatizantë të LSDM 56.4% e pranojnë këtë emër, ndërsa për simpatizantë të BDI-së 62.5% e përkrahin këtë emër.

Lidhjeve, Goran Sugaresvki, për mos mbajtje të premtimeve në ndërtimin e disa rrugëve magjistrale, ndaj ministres së Punës dhe Politikës Sociale për premtime të rreme për ngritjen e ndihmës sociale, dhe ndaj ministrit të Financave për gënjeshtër për rritjen e rrogës mesatare.

"Pse po gënjeni se do të rritni rrogën mesatare në 30 mijë denarë, kur nuk ka investime dhe nuk arrijte ekonomike. Maksimumi, sipas parametrave që vetë ju i keni dhënë, rroga mesatare për katër vitet e ardhshëm nëse nuk ka ndonjë stagnim, mund të rritet deri në 27 mijë denarë. Keni gënjer edhe për kthimin TVSH-së. Si do ta bëni këtë kur nuk keni mbledhur para për kthimin e TVSH-së edhe atë rreth 500 mijë ekonomive familjare në Maqedoni. Pranoni se keni gënjer qytetarët", pyetën deputetët e VMRO-së. Zëvendësmministria e Financave, Shirete Elezi lidhur me rritjen rrogës mesatare u mbështet te stabiliteti makroekonomik i shtetit dhe rritja e rrogës minimale që, sipas saj, bënë që rroga mesatare të shënojë rritje të menjëhershme.

MICKOVSKI THËRRET PËR PROTESTË MASIVE TË SHTUNËN

Kryetari i VMRO-DPMNE-së, Hristijan Mickovski, ka vazhduar me aktivitetet e tij në prag të protestës së organizuar nga partia e tij për më 2 qershor. Ai në takim me qytetarët në Prilep, ka akuzuar qeverisjen e Zoran Zaevit duke e cilësuar si të stërmëshur me gënjeshtër dhe premtime jo reale. Siç njofton ai, kjo qeverisje e tanishme nuk ka pasur asnjë progres në asnjë sferë në shtet. Ndërsa gjatë takimit ka thirrur banorët e Prilepit që të i bashkohen protestës para Qeverisë më 2 qershor.



15 marrëveshje të reja me Kosovën

Mbledhja e përbashkët në mes të Qeverisë së Maqedonisë dhe Qeverisë së Kosovës pritet të mbahet së shpejti, ka bërë të ditur për gazetën "Epoka e re", zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, Enver Hoxhaj. Ai ka treguar se në këtë mbledhje pritet të nënshkruhen 15 marrëveshje të cilat i përkasin fushës së drejtësisë, sigurisë, shëndetësisë dhe ekonomisë. Analistët politikë Blerim Reka dhe Imer Mushkolaj kanë mirëpritur mbajtjen e kësaj mbledhje, por kanë kërkuar zbatimin e marrëveshjeve të arritura. Sipas tyre, duhet të ndërmerren hapa konkretë për ta lehtësuar jetën e qytetarëve në të dyja anët e kufirit.

Shkup, 5 të lënduar rëndë në 9 aksidente

Pesë persona kanë marrë lëndime trupore të rënda, ndërsa dy janë lënduar lehtë në nëntë aksidente të regjistruara gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup. Policia e trafikut i ka sanksionuar 59 shoferë të cilët kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar, ndërsa i ka përjashtuar nga komunikacioni tre shoferë nën ndikimin e alkoolit, 17 para se ta fitojnë të drejtën e drejtimit të automjetit motorik, tre fillestarë dhe pesë të tjerë. MPB informoi se nga komunikacioni janë përjashtuar 17 automjete të paregjistruara, dy automjete me defekte teknike, 16 me afat të skaduar të lejes për qarkullim, 181 automjete të parkuara në mënyrë të padrejtë dhe 56 automjete të larguara nga karroceteci.

Rrihet një burrë në një restorant të Shkupit

Një burrë është rrahur në një restorant të Shkupit nga katër persona pas një zënke verbale. Personi V.S. (49) nga Shkupi si klient në një restorant pas një zënke verbale me kamarierin Z.S. (35) është sulmuar fizikisht nga ai, si dhe nga tre persona të tjerë jashtë restorantit. Incidenti ka ndodhur dje në ora 17:15 në një restorant në rrugën "Maqedonia". Ndërmerren masa për zbardhjen e plotë të rastit.

ALEANCA PËR SHQIPTARËT PËR NJËVJETORIN E QEVERISË

SHQIPJA DHE DREJTËSIA, DËSHTIMET E QEVERISË

Zëdhënësi i ASH-së, Flakron Bexheti, nga ato që tha gjatë konferencës për shtyp për njëvjetorin e Qeverisë, e llogariti të dështuar në të gjitha planet kryeministrin Zaev, duke mos kursyer kritika as për partnerin shqiptar në Qeveri, BDI-në e Ali Ahmetit

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 31 maj - Në kuadër të njëvjetorit të Qeverisë, Aleanca për Shqiptarët e Zaidin Selës ka adresuar kritika të forta kundër kryeministrin Zaev dhe kabinetit të tij qeveritar. Fillimisht, zëdhënësi partiak Flakron Bexheti gjatë një konference për shtyp të mbajtur të enjten në Tetovë theksoi faktin se Qeveria Zaev nisi mirë reformat përderisa partia e tij ishte në Qeveri.

"Qeveria LSDM-BDI, e cila e nisi rrugëtimin e vetë si Qeveri Reformatore, nga qytetarët u prit si Qeveri shpëtimi, që do siguronte kushte normale për jetë më të dinjitet, mbase edhe kishte një fillim të suksesshëm që premtonte ardhmëri më të mirë. Një fillim i mbarë, kur në qeverisje merre pjesë edhe Aleanca për Shqiptarët, ishte shprehëdhënës edhe për shqiptarët. Tani më, në rrumbullakimin e njëvjetorit të kësaj qeverisjeje, si duket, shpresa për suksese, si rezultat i premtimeve në fusha të ndryshme të shoqërisë po shuhet", tha Bexheti. Ai u shpreh se ASH vlerëson se kjo qeverisje dështoi në shumë plane të premtimeve parazgjedhore.

"Zhagjitja e hyrjes në fuqi e Ligjit të gjuhës shqipe, që ishte projekti më serioz i Marrëveshjes së Ohrit dhe mosgatishmëria e kryetarit të Parlamentit ta shpall atë në Gazetën Zyrtare dëshmoi se BDI nuk ka kapacitete të plota qeverisëse. Mos përfillja e partive shqiptare opozitare për çështjen e emrin në tryezën e liderëve, për zgjedhjen e kontestit të emrit të Maqedonisë, dhe përfaqësimi i shqiptarëve vetëm nga BDI që, sipas rezultateve të fundit zgjedhore, nuk e përfaqëson shumicën e shqiptarëve. Dështimi në reformat e sistemit të drejtësisë", ishin këto kritikat



që ASH adresoi ndaj partive në pushtetit. Për sistemin drejtësisë, Bexheti radhiti një sërë ndodhish që, sipas tij, flasin për dështimet në reformat pushtetin gjyqësor.

"Zgjedhja aq e prituri e Prokurorit Publik dështoi që në fillim. Puna e parë e Prokurorit Publik ishte rikualifikimi i veprës penale për rastin e Almirit, nga vrasje me paramendim, në një incident të thjeshtë komunikacioni. Zgjedhja e disave nga kryetarët e Gjykatave themelore, nga Këshilli gjyqësor republikan, ishte me ndikim politik të LSDM dhe BDI, sepse zgjedhën kuadro të afërt më këto dy subjekte politike, ashtu siç vepronte VMRO-BDI gjatë qeverisjes paraprake. Këshilli Gjyqësor republikan, në asnjë mënyrë nuk e garantoi pavarësinë e gjyqësorit, po e pengon edhe më shumë autonominë e tij, konstatim ky që u vërtetua edhe nga raporti i Pribes.

Mosndëshkimi i gjykatësve, prokurorëve, dhe inspektorëve të policisë, që kanë montuar procese politike me dënime maksimale siç është rasti i Sopotit, i Monstrës si dhe heshtja e vazhdueshme për ta zbardhur rastin e Kumanovës. Dinamika e ngadalshme e procesimit të lëndëve të ndryshme për vepra penale që janë hapur nga Prokuroria Publike Speciale. Dështimi i Këshillit për reforma në drejtësi, që u dëshmuar edhe nga dorëheqja e disa ekspertëve të kësaj fushe", ishin të gjitha këto kritikat ndaj Qeverisë Zaev për pushtetin gjyqësor nga ana e zëdhënësit të ASH-së, Flakron Bexheti. Ai përmendi dhe mosndëshkimin e disa zyrtarëve të BDI-së, siç tha Flakron Bexheti, të cilët kanë qenë pjesë e qeverisjes me VMRO për të cilët ka dyshime për vepra të ndryshme penale, korrupsion, krim të organizuar dhe falsifikim zgjedhor.

VETËM 5 PËR QIND E BUXHETIT NË DUART E MINISTRAVE SHQIPTARË

Në lidhje me sektorin e Ekonomisë, Bexheti tha se Maqedonia është vendi i vetëm në Ballkan që nuk shënoi rritje ekonomike në vitin 2017, fakt ky që u vërtetua edhe në dialogun e Bashkimit Evropian me shteteve të Ballkanit perëndimor. "Rritja e borxhit publik si në kohën e regjimit të kaluar. Vazhdon edhe me tej diskriminimi ekonomik ndaj shqiptarëve, andaj pyesim Kryeministrin Zaev, ku është përmirësuar gjendja në shpërndarjen e parasë publike për komunat shqiptare, dhe nga rritja e 18 milionë eurove për transferet për pushtetin lokal, sa ndahen për komunat shqiptare? Nga rritja për 50 % të buxhetit e fondit për vise të pazhvilluara e pyesim kryeministrin Zaev, sa nga këto mjete planifikohen për Komunat shqiptare", tha Flakron Bexheti. Ai pyeti kryeministrin Zaev se pse ministrat shqiptarët menaxhojnë me ministratë vetëm me 5% të mjeteve buxhetore? "E pyesim Kryeministrin Zaev nëse punësimi qenka prioritet për qeverinë, pse kjo e drejtë iu mohohet qytetarëve të Gostivarit me bllokimin e buxhetit nga ana Juaj, dhe a është ky diskriminim mbi baza etnike? Dështimi i reformave të premtuara në Arsim dhe Shëndetësi. Reformat në Arsim dhe Shëndetësi as që kanë filluar, ndërsa infrastruktura vazhdon të jetë e mjerueshme në këto institucione", tha zëdhënësi Bexheti.

OSMANI PRITI AMBASADORIN ZHBOGAR

Plani 3-6-9 deri në fillim të negociatave me BE-në

Shkup, 31 maj - Zëvendëskryeministri i angazhuar për çështje evropiane, Bujar Osmani, dje në hapësirat e Sekretariatit për çështje evropiane, e prezantoi planin e ri reformues, Planin 18 para përfaqësuesve të Delegacionit të BE-së në Maqedoni, të kryesuar nga euroambasadori Samuel Zhubogor. Osmani ka shprehur

kënaqësi nga implementimi i Planit 3-6-9, sidomos, siç theksoi, valorizimi i tij në njërën nga raportet më pozitive për Republikën e Maqedonisë, e cila ka qenë i shoqëruar me rekomandim të pastër dhe të pakushtëzuar për negociatën nga ana e Komisionit Evropian. "Qeveria ka përcaktim të fuqishëm që ta mbajë

agjendën reformuese në majë të listës, prioritetet dhe pas përfundimit të implementimit të Planit 3-6-9, për çka Sekretariatit për çështje ekonomike ka ndërmarrë detyrim që të hartojë plan të ri reformues për vitin 2018, realizimi i së cilës duhet të përfundojë me daljen e raportit të ri të Komisionit Evropian në fillim

të vitit të ardhshëm", tha Osmani. Ai shtoi se Plani 18, që ende është në fazën e harmonizimit, pritet të kalojë në Qeveri javën e ardhshme, pas së cilës do të vendoset në ekspertizë edhe të opinionit publik dhe sektorit civil. Osmani kërkoi nga euroambasadori Samuel Zhubogor dhe nga përfaqësuesit e De-

legacionit të Bashkimit Evropian në Maqedoni edhe ata të kontribuojnë me vërejtje të tyre, sugjerime dhe komente gjatë finalizimit të përmbajtjes së Planit. Zëvendëskryeministri paralajmëroi se Plani së shpejti do të prezantohet edhe para administratës së Bashkimit Evropian në Bruksel.

Goditjet e shpejta dhe të rënda, kryesisht në kokë, janë pamjet e fundit të prezantuara në videon e Prokurorisë së Shkupit, pas të cilët deputeti Ziadin Sela e humb vetëdijen. I shtrirë për dysheme, pa shenja për jetë, Sela vazhdon të goditet dhe shkilet nga dhunuesit

NJË VIDEO E RE DEMASKON "PAFAJËSINË" E DHUNUESVE

VULOSET TENTIM-VRASJA NDAJ SELËS



qelma. Në këtë rast qartë shihet edhe i akuzuari Oliver Oshavkovski, se si me shufra të hekurit e godet Selën, respektivisht pas tij vijojnë goditjet e të akuzuarit Kosta Dellov. Këto dëshmi materiale, të cilët në formë shtesë u prezantuan nga Prokuroria e Shkupit, i kanë lënë më gojë hapur të akuzuarit dhe familjarët e tyre. Qëndrimet e deridjeshme të të akuzuarve se në Parlament janë futur për shkak të kuriozitetit dhe se të njëjtit nuk kanë asnjë farë lidhje me sulmin ndaj Selës, me këtë dëshmi bien në ujë të gjitha.

Ndryshe, siç në këto pamje nuk u vërejtën veprimet e të akuzuarve Kire dhe Cejo Gjeorgjievski, të cilët në videot mëhershme shiheshin se si e nxjerrin Selën nga salla e shtypit në Parlament dhe të njëjtin e shëtisin nëpër korridorë. Për veprën penale "tentim vrasje" ndaj deputeti Ziadin Sela, Prokuroria e Shkupit i ngarkon edhe të akuzuarit Sasho Senkov, Andrej Micov, Stojan Pavlevski dhe Nikollçe Dimitiresvki. Pas përfundimit të prezantimit të këtyre provave, në këtë proces gjyqësor dëshmitë e tyre pritet t'i prezantoj pala mbrojtëse, e cila siç komentohet, të akuzuarit vështirë se do të mundet të demantojnë apo përgënjeshtrojnë ndonjë dëshmi, sidomos video-materialet e prezantuara së fundmi.

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 31 maj - Ashtu siç afrohet fundi i procesit gjyqësor kundër sulmuesve të Ziadin Selës, Prokuroria e Shkupit i prezantoi edhe dëshmitë e radhës materiale, të cilët kryesisht përmbajnë inserte nga rrahja brutale e kreut të Aleancës për Shqiptarët, Ziadin Sela. Në videon e radhës të cilët e publikoi Prokuroria e Shkupit, krahas atyre të mëhershmeve, shihet qartë se si Sela, në mënyrën më të egër shkelet në kokë, goditet dhe tërhiqet zvarrë. Për dallim nga pamjet që Prokuroria e publikoi para opinionit në seancat e kaluara, në seancën e ditës së enjte publiku por edhe vetë familjarët e të akuzuarve patën mundësi të shohin se si të afërmit e tyre marrin pjesë në linçimin e Ziadin Selës.

Nga të gjitha dëshmitë dhe deklaratat e prezantuara deri më tani, videoja e fundit e ku shihet rrahja e tmerrshme e Selës, më 27 prill të vitit të kaluar, e tregon

qartë implikimin dhe përfshirjen e 10 të akuzuarve në sulmin ndaj deputetit shqiptar.

Veprimet dhe roli i të akuzuarit Aleksandar Janevski-Toshta gjatë rrjedhës së deritanishme të procesi gjyqësor për Selën, shpesh është kontestuar si i padrejtë duke dashur që ky i akuzuar të prezantohet si shpëtimtar i kreut të Aleancës për Shqiptarët. Mirëpo, video-materiali i publikuar të enjten në gjykatën plotësisht e demantoi një tezë të tillë.

Nëse deri tani Toshta shihej se si i mbron deputetët nga sulmet e bashkë të akuzuarve të tij, ai në këtë video shihet se si i drejton hujliganët në drejtim të Selës, të cilët

bërtasin "sille këtu, sille këtu".

Në mesin e shumë personave me maska në sallën për shtyp në Parlament, në këtë video po ashtu shihet njëri prej tyre se fillon t'i godas deputetët, sigurimin e Oliver Spasovskit dhe për një moment, ai kalon nga i akuzuari Janevski dhe e tërheq zvarrë deputetin Sela.

Tutje, personi me maskë ju bën me shenjë të tjerëve, ku vërehet i akuzuari Nikolla Vojminovski dhe të gjithë bashkërisht i vërsulen Selës. Goditjet e shpejta dhe të rënda, kryesisht në kokë, janë pamjet e fundit të prezantuara në videon e Prokurorisë së Shkupit, pas të cilët deputeti Ziadin Sela e humb vetëdijen. I shtrirë për dy-

sheme, pa shenja për jetë, Sela vazhdon të goditet dhe shkilet nga dhunuesit. Ata nuk mjaftohen me gjendjen e tij dhe fillojnë ta godasin me mjete të hekurta dhe sh-

ZVOGËLOHET NUMRI I VEPRAVE PENALE

Enti shtetëror për statistikë shënon ulje të numrit të personave të paraqitur madhor, kryerës të njohur të veprave penale, për 10.6 për qind në vitin 2017 në krahasim me vitin paraprak 2016. Sipas ESHS, në vitin 2017, në krahasim me vitin 2016, numri i personave të dënuar është zvogëluar për 23.2 për qind, ndërsa numri i personave të akuzuar, gjithashtu është zvogëluar për 20.4 për qind. Numri i fëmijëve të denoncuar në përplasje me ligjin - kryerës të veprave penale, në vitin 2017, në krahasim me vitin 2016, është zvogëluar për 1.5 për qind. Në vitin 2017, në krahasim me vitin 2016, numri i fëmijëve të dënuar në përplasje me ligjin - kryerës të veprave penale është zvogëluar për 21.4 për qind.

KONFERENCË PËR SIGURINË E RAJONIT

Nuk ka rrezik nga kërcënimet ushtarake

Shkup, 31 maj - Rreziku nga kërcënimi ushtarak klasik në afat më të gjatë për Maqedoninë dhe rrethimin i tij i drejtpërdrejtë nuk pritet, por për këtë kërcënime joushtarake jo vetëm që e modifikojnë formën e tyre, por adaptohen në jetesën moderne, u bënë të llojllojshme dhe u rritën, sipas intensitetit, hapësirës dhe kohës. Ky është konkluzioni i konferencës së djeshme "Siguria nga aspekti i gjendjeve aktuale të brendshme dhe kërcënimeve globale asimetrike", organizuar nga Klubi i gjeneralëve, Klubit diplomatik të Maqedonisë, Forumit ballkanik për siguri dhe Shoqatës së veteranëve dhe rezervistëve nga mbrojtja dhe siguria. Ekspertët shkëmbyen edhe opinione për dimensionet e reja të kërcënimeve ushtarake në kontekst të sfidave globale, me kthesë të

veçantë mbi faktorët që ndikojnë ose mund të shkaktojnë kërcënime mbi sigurinë në vend. Konkluduan se vetëm me strategji të mirë mund të zgjidhen problemet, për çka shteti duhet të ketë politikë përkatëse të sigurisë, të bazuar në analizë të hollësishme të rreziqeve. Përmendën se në këtë kontekst është mjaft me rëndësi anëtarësimi i Maqedonisë në organizatat e ndryshme ndërkombëtare, para se gjithash në NATO dhe BE. Bllagoja Markovski, kryetar i Forumit ballkanik për siguri theksoi se konferenca ndodh në periudhë jashtëzakonisht të rëndësishme për vendin, në planin e brendshëm dhe të jashtëm. Në planin e brendshëm, shtoi ai pas një periudhe më të gjatë dekadëshe në RM kanë filluar proceset e demokratizimit të shoqërisë. Në planin e jashtëm ka

filluar procesi për realizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në vend, me zhvillim të marrëdhënieve të mira ndërfaqjësore, fillimisht me Republikën e Maqedonisë, si dhe me negociatat për emrin me Greqinë, me çka do të hapen rrugët deri te qëllimi i dëshiruar, anëtarësimi në BE dhe NATO. Të pranishmëve iu drejtua edhe ministri i Punëve të Brendshme, Oliver Spasovski, i cili përmendi se zhvillimi i segmentit të sigurisë, si në raport me vendosshmërinë e tij sistematike, ashtu edhe në pikëpamje të sfidave të sigurisë, është proporcional me intensitetin dhe dinamikën e zhvillimit shoqëror dhe civilizues. Ai potencoi se shoqëria është e obliguar t'i shfrytëzojë të gjitha kapacitetet dhe potencialet në observim të vazhdueshëm, zhvillim dhe sendërtim të sistemeve



dhe koncepteve të sigurisë. Dekani i Fakultetit të sigurisë, Nikolla Dujovski, shprehu pritje se së shpejti do të ketë progres më serioz në raport me integritimin e Maqedonisë në NATO. Siguria në Maqedoni është në nivel stabil, ndërsa

avantazhet me anëtarësim, siç sqaroi, para se gjithash, nuk kanë të bëjnë me sundimin e drejtësisë, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, ndërsa më shumë mundësi për progresin ekonomik. (O.Xh)

Komunat rurale ankohen se në praktikë ekzistojnë edhe probleme të caktuara për shfrytëzimin më të madh të mjeteve IPARD. Kërkohej edhe anulimi apo ulja e pagesës së TVSH-së për projektet evropiane duke marrë parasysh kondicionin e dobët financiar të komunale

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 31 maj - Sa komunat rurale të banuara me shqiptarë i shfrytëzojnë fondet evropiane? Nga analiza e deritanishme rezultoi se fitimi dhe realizimi i projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian për përmirësimin e infrastrukturës, nuk është një mision i pamundur për komunat rurale shqiptare në Maqedoni. Ekzistojnë më shumë shembuj të komunave që me sukses aplikojnë dhe fitojnë mjetet evropiane për përmirësimin e kushteve të jetesës në viset rurale.

KËRKESAT E KOMUNAVE SHQIPTARE

Megjithatë, komunat rurale ankohen se në praktikë ekzistojnë edhe probleme të caktuara për shfrytëzimin më të madh të mjeteve të IPARD të dedikuara për përmirësimin e cilësisë së jetesës në vendbanimet rurale, rindërtimin dhe zhvillimin e fshatrave, si dhe ruajtjen dhe avancimin e vlerave tradicionale në viset rurale. Kërkohej edhe anulimi apo ulja e pagesës së TVSH-së për projektet evropiane duke marrë parasysh kondicionin e dobët financiar të komunale rurale të cilat nuk kanë në kufijtë e tyre administrativ, biznesi të fuqishme që punësojnë me mijëra punëtorë apo që derdhen shuma të mëdha në arkën e komunës në emër të pagesës së tatimeve të ndryshme.

"Komuna jonë në parim nuk ka pasur problem me thithjen e fondeve të ndryshme evropiane si ato të bashkëpunimit ndërkufitar, IPARD etj. Megjithatë, nëse flasim në përgjithësi për komunat rurale dhe sidomos ato shqiptare, nevoj-

FONDE EVROPIANE PËR ZHVILLIM RURAL

IPARD FINANCON VETËM PROJEKTE CILËSORE



tet që në të ardhmen të zgjidhet problemi me pagesën e Tatimit të Vlerës së Shtuar nga ana e komunave për realizimin e projekteve që në praktikë do të thotë se për mjetet e fituara prej 1 milion euro do të paguani 180 mijë euro, andaj komunat rurale edhe nuk përfundojnë projektet, i lënë përgjysmë apo ndodh që të heqin dorë prej tyre për shkak se nuk kanë mundësi të paguajnë shumën të mëdha për pagesën e tatimit", thotë Erkan Arifi, kryetar i Komunës së Likovës.

Sipas tij, është pozitive se është tejkaluar problemi i viteve të kaluara, kur për projektet të caktuara kanë mundur të konkurrojnë vetëm fshatrat deri më 1000 banorë, ndërsa tani mund të fitojnë mjete edhe fshatrat me 3000 apo 4000 banorë. Gjithashtu është premtuar se do të rriten mjetet e IPARD për vitin 2019 që aktualisht ka në dispozicion mjete në vlerë prej 12 milionë euro.

"Është për të përhëndetur edhe fakti se është zgatur afati i aplikimit deri në mesin e muajit maj, në vend të muajit mars. Me fjalë të tjera, komunat kanë fituar edhe dy muaj shtesë kohë që të përmirësojnë dhe evitajnë gabimet eventuale gjatë aplikimit për mjetet IPARD", sqaron Arifi.

Kryetarët e komunave të tjera rurale kërkojnë edhe më shumë llogaridhënie gjatë realizimit të projekteve të ndryshme nga ana e Agjencisë Pagesore, për shkak se sipas tyre mjetet evropiane para-

tesin të vetmet të hollat që mund të përmirësojnë kushtet themelore të jetesës në vendbanimet rurale.

"E vetmja mënyrë që komunat rurale të riparojnë apo ndërtojnë infrastrukturën themelore për banorët e tyre si rrugët, ujësjellësin apo kanalizimin, janë mjetet evropiane IPA dhe IPARD. Ne si komunë në vazhdimësi kemi konkurruar në projekte të tilla, ku edhe kemi fituar projekte të caktuara, megjithatë mund të them se gjatë ndarjes së mjeteve mund të ndodhin edhe padrejtësi të caktuara, andaj nevojitet një transparencë maksimale dhe llogaridhënie më e madhe se si në çfarë mënyre një komunë rurale i ka plotësuar kriteret e përcaktuara për fitimin e mjeteve IPARD", thotë kryetari i komunës së Studenicanit, Azem Sadiku.

Sipas tij, në parim nuk është vështirë të aplikohet, të përkthehen dokumentet e nevojshme në gjuhën angleze, të përgatiten elaboratet e ndryshme për mbrojtjen e ambientit etj. Nevojitet që edhe komunat rurale shqiptare të tregojnë një gatishmëri, angazhim dhe përgatitje më të madhe me qëllim të shfrytëzimit maksimal të fondeve evropiane, shton më tej Sadiku.

Edhe nga komunat e tjera rurale e thonë se nuk është e pamundur të tërhiqen mjetet e evropiane për ndërtimin e infrastrukturës, në rast se plotë-

sohen kriteret mjaft të rrepta të aplikimit.

IPARD KËRKON RREGULLA STRIKTE

"Programi IPARD në parim kërkon rregulla strikte të lojës që përcaktohen nga Komisioni Evropian, projekte më cilësore si dhe kapacitete të vetë komunave rurale që të plotësojnë të njëjtat. Përvoja jonë si komunë është pozitive, dhe tregojnë se mjetet edhe fitohen në fund në rast se plotësohen kërkesat e ndryshme. Nëse je i përgatitur dhe nëse ke projekte mirë të përgatitura që i plotësojnë standardet rigorozë, në atë rast edhe nuk paraqet ndonjë problem të veçantë që të fitohen këto të holla. Megjithatë ndodh që komunat rurale t'ju mungojnë kapacitetet e brendshme për përgatitjen e këtyre projekteve apo ju mungojnë edhe projektet serioze për shkak se kushtet e kërkuara gjatë aplikimit janë mjaft decide dhe kërkohej që me 100 për qind të plotësohen kushtet", thotë kryetari i Komunës së Bërvenicës, Enver Pajaziti.

Në ndërkohë nga Bashkësia e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale që përfaqëson të 84 komunat në Maqedoni, kërkojnë edhe përshtetimin e procedurave për ridestininimin e tokës ndërtimore në tokë bujqësore nga ana e institucioneve shtetërore në favor të zhvillimit ekonomik të komunave rurale. Kërkohej edhe rritje e mjeteve financiare për komunat rurale në pjesën e mjeteve të shitjes së tokës shtetërore bujqësore, si dhe rritjen e mjeteve për komunat në bazë të koncesioneve për shfrytëzimin e ujit, kullosave, pyjeve etj. Komunat kërkojnë edhe thjeshtësimin e procedurave për miratimin e planeve për planifikimin e hapësirës.

Ndryshe, komunat rurale në Maqedoni prej vitit të ardhshëm do të kenë në dispozicion mjete në vlerë prej 12 milion euro të programit IPARD, për të cilat do të aplikojnë prej muajit të ardhshëm.



ERKAN ARIFI

Nëse flasim në përgjithësi për komunat rurale dhe sidomos ato shqiptare, nevojitet që në të ardhmen të zgjidhet problemi me pagesën e Tatimit të Vlerës së Shtuar nga ana e komunave për realizimin e projekteve që në praktikë do të thotë se për mjetet e fituara prej 1 milion euro do të paguani 180 mijë euro, andaj komunat rurale edhe nuk përfundojnë projektet, i lënë përgjysmë apo ndodh që të heqin dorë prej tyre për shkak se nuk kanë mundësi të paguajnë shumën të mëdha për pagesën e tatimit



AZEM SADIKU

Në parim nuk është vështirë të aplikohet, të përkthehen dokumentet e nevojshme në gjuhën angleze, të përgatiten elaboratet e ndryshme për mbrojtjen e ambientit etj. Nevojitet që edhe komunat rurale shqiptare të tregojnë një gatishmëri, angazhim dhe përgatitje më të madhe me qëllim të shfrytëzimit maksimal të fondeve evropiane

Sivjet programi ka vlerën prej 34 milion euro, ndërsa të hollat kryesisht shkojnë për projekte të vjetra që tani paguhen dhe realizohen. Në bazë të Programit për Përkrahje financiare të Zhvillimit Rural, në vitin 2018 ofrohen më shumë investime që ndahen në tre masa kryesore si "Përmirësimi i cilësisë së jetesës në vendbanimet rurale", "Rindërtimi dhe zhvillimi i fshatrave", si dhe "Ruajtja dhe avancimi i vlerave tradicionale në viset rurale". Të gjithë këto masa janë të dedikuara për investime të ndryshme kapitale në infrastrukturën rurale.

Projektua borxh dukshëm më të ulët nga qeveria paraprake

Shkup, 31 maj - Me strategjinë e re fiskale, projektimet për borxhin publik janë dukshëm më të vogla në krahasim me strategjinë e fundit fiskale të qeverisë së mëparshme. Mesatarisht, bëhet fjalë për rreth 3,5 për qind pikë më pak çdo vit, deklaroi ministri i Financave Dragan Tevdovski në një emision

në televizionin Alsat M. "Në pajtim me strategjinë e fundit fiskale të qeverisë paraprake nga tetori i vitit 2016, për vitin 2017 parashikohej borxh publik prej 53,1 për qind. Kjo qeveri e përfundoi vitin 2017 me 47,6 për qind borxh publik apo madje për 5,5 për qind pikë më pak. Për herë të parë pas

tetë vjetëve kemi ulje të borxhit publik në nivel vjetor në vitin 2017. Në pajtim me strategjinë e fundit të qeverisë paraprake nga tetori i vitit 2016, në vitin 2019 u planifikua borxhi publik të arrijë 56 për qind, dhe kush e di sa më pas. Me strategjinë e re fiskale maksimumi që e projektojmë është 54,8

për qind nga BPV-ja në vitin 2020, i cili më pas vitin e ardhshëm ulet, gjegjësisht është në linjë rënieje. Është planifikuar konsolidim gradual buxhetor i cili parashikon deficitin buxhetor të ulet në dy për qind nga BPV në vitin 2021", tha Tevdovski. Siç theksoi ai, deri tani në këtë periudhë nuk ka pasur

strategji fiskale dhe nuk mundet të jepen komente. Kjo është hera e parë pas 10 vjetëve të sille të kohë strategjia fiskale. Ministri i Financave theksoi se projektimi themelor në të cilin bazohet strategjia fiskale është se do të intensifikohet rritja ekonomike në vitet e ardhshme.

ULJA E NATALITETIT, SHKAQET DHE PREVENTIVAT

MË PAK LINDJE, MË SHUMË MIGRIM

Dikur nënat lindnin më shumë fëmijë, edhe përkundër kushteve të vështira ekonomike e sociale. Por sot është ndryshe. Ekspertët detektojnë disa shkaqe që ndikojnë në rënien e lindshmërisë

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 31 maj - Mosinteresimi i prindërve për të patur fëmijë të dytë ose të tretë si dhe shpërngulja e madhe e qytetarëve jashtë shtetit, kanë ndikuar dukshëm në rënien e natalitetit të popullatës në Maqedoni, ndërkohë që masat stimuluese që i inicioi qeveria e kaluar, sipas mjekëve dhe demografëve, nuk arritën efektin e dëshiruar.

Varësisht në cilat mjedise sociale jetojnë qytetarët, si dhe niveli arsimor i tyre, mund të flitet edhe për shkaqet e rënies së natalitetit. Profesorët universitarë mendojnë se ulja e natalitetit vjen nga mosarsimimi i femrës shqiptare, mosinkuadrimi i saj në punë, por edhe nga pagat e ulta në vendin e punës.

KONCENTRIMI NË SHKUP, ULLINDSHMËRINË NË KOMUNAT TJERA

Në repartin Obstetrikë-Gjinekologjik në Gostivar në dekadën e fundit ka një ulje drastike të lindshmërive. Sipas kryeshefit të repartit, dr. Agim Jakupi shkaqet janë politike, por edhe ekonomike. Ai sqaron për gazetën KOHA se në këtë repart viteve të fundit është evident zvogëlimi i lindjeve. Këtë ai e ilustron më të dhëna konkrete, duke krahasuar vitet dhe periudhat kohore. Kështu që, sipas tij, para 17 viteve kur edhe është punësuar në Spitalin e Gostivarit, ka patur 1300 lindje në vit, ndërkohë që viteve të fundit shifra e lindshmërisë zbrit në 680 foshnje. Por statistikat e vitit të fundit shënon një rritje prej 5 lindjeve, më shumë se vjet.

Dr.Jakupi përmend migrimin e popullatës, sidomos i moshave të reja, si një nga arsytet e rënies së natalitetit. Si shkaqe të tjera ai evidenton edhe situatën e disfavorshme ekonomike e sociale në vend që nënkupton faktin se prindërit e punësuar me rroga të ulëta, nuk kanë mundësi që të lindin më shumë se dy fëmijë. Nuk është si dekada më parë kur nënat shqiptare edhe përkundër kushteve të vështira ekonomike lindnin edhe nga 5, 6 fëmijë, thotë ai.

Pakojat e programeve stimuluese nga ana e qeverisë pararendëse, në thelb ishte diskriminues, për ar-



sye se favorizonte vetëm një pjesë të popullatës. Dr.Jakupi ka vërejtje në këtë aspekt sepse këto stimulime i dedikoheshin vetëm komunave në Maqedoninë Lindore, kurse pjesët tjera, të banuar kryesisht me shqiptarë, i nënshtroheshin kriterëve absurd që në të shumtën e rasteve bëhej përmes pengimeve në dokumentat si të pakompletuara.

Një shkak tjetër i zvogëlimit të numrit të lindjeve, sipas kryeshefit të repartit të Obstetrikës-gjinekologjisë në Gostivar, dr.Agim Jakupi, qëndron në atë se Ministria e Shëndetësisë ka dhënë mundësinë që gratë shtatzëna të zgjedhin vendin e lindjes ku të duan, pa rekomandim të mjekut sekondar.

"Ju dha mundësia grave shtatzëne që të zgjedhin vetë vendin e lindjes, por nga ana tjetër u bë një politikë e padrejtë, për ta rritë numrin e lindjeve në klinikën e Shkupit, i cili ishte në rënie e sipër. Çdo paciente që shkon në muajin e pestë në "skrining" (ndjekje e shtatzënisë), në Shkup, iu bëhet me dije se janë raste pak më specifike dhe që duhet të lindni në klinikë. Domethënë një pjesë dermuese të pacienteve na i tërhoqën për lindje. Këto dhe shkaqe të tjera kanë ndikuar që gjatë 15 viteve të fundit lindshmëritë në repartin tonë të bien për rreth 55 për qind", saktëson dr.Agim Jakupi, duke përmendur edhe funksionimin e klinikave private me standarde të larta si shkak i ikjes së pacienteve nga klinika ku ai punon.

Për dallim nga Spitali i Gostivarit, një ndryshim pozitiv vërehet në spitalin Gjinekologjik dhe Obstetrikë "Nënë Tereza" në Shkup. Siç njoftojnë për gazetën "Koha" në dy vitet

FAUZI SKENDERI

Ajo që është me rëndësi dhe që mund të quhet "thikë me dy teha", në diasporë kemi shtimin e lindshmërisë te komuniteti shqiptar, që do të thotë se ajo ka ndikuar që kohët e fundit ta kompenzojë uljen e natalitetit të komunitetit shqiptar në Maqedoni. Por, problemi i uljes së natalitetit në nivel shtetëror qëndron diku tjetër, urbanizimi i jetës në fshat dhe mospërfshirja e femrës shqiptare në proceset shoqërore-ekonomike

e fundit, në këtë spital, shënohet rritje prej 1100 lindjeve, ndonëse kjo shifër nuk e ndryshon numrin e lindshmërive në nivel republikan.

"Në spitalin tonë këto dy vitet e fundit kemi rritje të numrit të lindjeve nga 2800 lindje në 3900 lindje, që sipas dinamikës së tashme dhe me numrat me të cilat udhëhiqemi tash, jemi të bindur që këtë vit 2018 do ta përmbyllim me rreth 4200 lindje, dhe kjo do të thotë se jemi në epërsi nga spitalet e tjera të vendit, edhe pse paciente kemi nga gjithë qytet e Maqedonisë", tha doktor Ilir Shurdhani, nga spitali i Gjinekologjisë dhe Obstetrikës "Nënë Tereza" në Shkup.

MIGRIMI SI PROBLEMI NATALITETIT

Si rrjedhojë e të rinjve që marthohen me vonësë, por edhe arsimimi i vonshëm i femrës shqiptare, problemi social dhe ekonomik, pasiguri

DR.AGIM JAKUPI

Pakojat e programeve stimuluese nga ana e qeverisë pararendëse, në thelb ishte diskriminues, për arsye se favorizonte vetëm një pjesë të popullatës. Këto stimulime i dedikoheshin vetëm komunave në Maqedoninë Lindore, kurse pjesët tjera, të banuar kryesisht me shqiptarë, i nënshtroheshin kriterëve absurd që në të shumtën e rasteve bëhej përmes pengimeve në dokumentet gjoja si të pakompletuara.

ria dhe të gjithë këto kanë ndikuar që të bie në masë të madhe lindshmëria.

Profesori universitar Fauzi Skenderi thotë për gazetën KOHA se shqiptarët në krahasim me komunitet e tjera në vend, janë më mirë, por largimi i të rinjve jashtë shteti ka ndikuar mjaft në zvogëlimin e popullsisë.

"Ajo që është me rëndësi dhe që mund të quhet "thikë me dy teha", në diasporë kemi shtimin e lindshmërisë te komuniteti shqiptar, që do të thotë se ajo ka ndikuar që kohët e fundit ta kompenzojë uljen e natalitetit të komunitetit shqiptar në Maqedoni. Por, problemi i uljes së natalitetit në nivel shtetëror qëndron diku tjetër, urbanizimi i jetës në fshat dhe mospërfshirja e femrës shqiptare në proceset shoqërore-ekonomike. Ajo që është edhe më problematike, hutia që është shkaktuar me këtë eksoduz nën hije, që

pak a shumë edhe i ngjason eksodusit të viteve "50, i organizuar nga qeveria Jugosllave, atëherë ku ndodhi shpërngulja e madhe e popullatës tonë për në Turqi, tani kur jemi dëshmitar se neve po na shterohen klasat fillore, të mesme, pastaj edhe universitetet, dhe atë çdo ditë e më tepër shpërngulet rinia. Vetëm në katedrën e Gjeografisë nga 30 studentë të regjistruar vitin e kaluar në vitin e parë, kanë mbetur 17 studentë këtë vit. Por edhe problemi ekonomik, ku rrogat janë të limituara, ndikon në uljen e lindshmërisë. Sot një fëmijë të rritësh është luks i madh, kurse puna e të rinjve që bejnë vlerësohet pak, ose është e pasigurt dhe shteti nuk iu del në ndihmë", nënvizon Fauzi Skenderi, pedagog i gjeografisë në UT. Sipas tij, më herët nënat tona kanë lindur më shumë fëmijë, por ata fëmijë që në moshë të re janë punësuar në fshatin e tyre, sepse në qytet nuk ka patur punësime për shqiptarët. Për dallim nga sot kur, siç thotë prof. Skenderi, kërkesat e fëmijëve janë më të lartë, ndiqen brendet e modës dhe përgjithësisht kostoja e jetës është më e shtrenjtë, procese botërore që kanë prekur edhe përditshmërinë tonë.

Statistikat e fundit tregojnë se Manastiri, Prilepi, Shtipi, Kumanova, Kërçova, Kavadarit janë vetëm disa nga komunat në Maqedoni që ka rënie të lindshmërisë dhe rritje të vdekshmërisë në tre muajt e parë të vitit 2018. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, numri i fëmijëve të lindur ka rënë për 1.6 për qind, ose për 5 255 lindje. Shifrat nuk janë më optimiste edhe në komunat më të vogla që kanë një numër më të vogël banorësh.

DEBAT I SHGM-së PËR SERVISIN PUBLIK TË MAQEDONISË

RTVM E REFORMUAR, MEDIA TË REFORMUARA

Selmani akuzoi se me insistimin që të mbahet drejtori i RTVM-së, VMRO është joparimore dhe nuk ndihmon që RTVM-ja të reformohet. "Edhe pse partia opozitare ka dorëzuar 70 amendamente për Ligjin për media, asnjëri nuk është esencial dhe nuk i dedikohet financimit të RTVM-së", tha kryetari i SHGM-së



Koha Evis HALILI

Shkup, 31 maj - Nuk ka reforma të vërteta në sferën mediale pa reformë serioze në Radio-Televizionin e Maqedonisë, që nënkupton lirim i saj partiak dhe punë profesionale. Financimi i qëndrueshëm është kusht për pavarësim politik të servisit publik, por jo edhe i vetëm sepse transformimi në një medium me ndikim dhe në një servis të vërtetë për qytetarët varet nga angazhimi i njëjtë të më shumë faktorëve - edhe nga jashtë, por edhe në vetë shtëpinë mediale. Ky është një nga konkluzionet nga diskutimi i djeshëm "Sfida për reforma në Ra-

dio-Televizionin e Maqedonisë" që e organizoi Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë. Kryetari i SHGM-së, Naser Selmani, tha se rekomandimi nga KE-ja është pavarësim politik dhe financiar i servisit publik, por që edhe pushteti dhe opozita këtë e pengojnë. "Pushteti e sulmon pavarësinë financiare të RTVM-së, ndërsa opozita përpiket t'i ruajë ushtarët e saj partiak. Qeveria në periudhën e kaluar fuqimisht ndërhyri në sistemin e financimit të RTVM-së, u pezullua taksa radiodifuzive dhe u vendos financim përmes Buxhetit. Kjo masë na u prezantua si e përkohshme, ndërsa

madje vëllimi i mjeteve është zvogëluar për 50 për qind. Nëse RTVM-ja në vitin 2016 kishte rreth 20 milionë euro buxhet, pa ndërhyrë se si ato janë shpenzuar, në gjashtë muajt e parë të këtij viti RTVM-ja ka rreth 10 milionë euro", tha Selmani, duke pyetur se si mund të bëhet servis më i fuqishëm dhe më profesional me më pak të holla. Habitët, tha ai, edhe nga raporti i opozitës, sepse ka fituar mundësi që me ndryshimet e reja të ligjit ta kontrollojë mënyrën e zgjedhjes së njerëzve të cilët do të hyjnë në Këshillin e programit, ndërsa nga ana tjetër, tha, e bl-

lokojnë ligjin. Sipas tij, me insistimin që të mbahet drejtori i RTVM-së, VMRO është joparimore dhe nuk ndihmon që RTVM-ja të reformohet. Vërejtje edhe se partia opozitare ka dorëzuar 70 amendamente për Ligjin për media, ndërsa asnjëri nuk është esencial dhe nuk i dedikohet financimit të RTVM-së.

"Ky është intervenimi me të cilit do të ndihmonin që të krijohet një servis publik më i fuqishëm", tha Selmani. Gazetarja e RTVM-së dhe anëtare e Këshillit Drejtues të SHGM-së, Filana Koka, tha se problemi më i madh në shtëpinë e tyre mediale është instalimi i kuadrit ga-

zetaresk partiak, që, tha, praktikohet nga viti 1996. "Nga atëherë RTVM-ja është në robërim dhe derisa nuk lirohet nga politika, që është shkatërruese për servisin publik, është e kotë që të flitet për reforma", tha Koka. Edhe Zoran Fidanovski, anëtar i ASHMAA, me qëndrim se derisa servisi publik trajtohet si pre zgjedhore, nuk do të ketë përmirësim thelbësor. "Për këtë fuqimisht insistojmë vend qendror në reformat mediatike të ketë servisi publik dhe të funksionojë të paktën si ata nga fqinjësia. Financimi i qëndrueshëm është sfondi i gjithçkaje. Fillim i mirë do të jenë 30 milionë euro në vit", tha Fidanovski.

Dejan Georgievski nga Qendra për Media, gjithashtu, konsideron se financimi është kyç. "Madje edhe dy për qind nga buxheti i vitit të kaluar me siguri janë shumë pak para nëse duam servis publik sipas standardeve ndërkombëtare dhe ajo që u duhet qytetarëve të cilët, përndryshe, deri më tani askush edhe nuk i ka pyetur çfarë duan. Zgjidhja e tanishme për financim ndoshta është stabile dhe paraparë në fat të mesëm, por jo edhe afatgjatë, sepse se as nga larg nuk do të jetë mjaftueshëm", tha Georgievski.

OPOZITA VËREJTJE TË SHUMTA NË KËSHILLIN E TETOVËS

Të pakënaqur me pastrimin e qytetit

"Shumë kontejnerë janë edhe pa rrota, janë të dëmtrar. Është turp për një qytet si Tetova, ku lumi Shkumbin kalon përmes qytetit, ka ujë çdoherë dhe vetëm mungesa e vullnetit ka bërë që të mos lahen rrugët. Nëse u vjen mërzi apo nuk ju punohet atyre atje, le të tregojnë, ka kush punon pa pare, unë vetë do të shkoj do ti mbush cisternat dhe do ti laj rrugët", tha Adnan Bilalli, këshilltar i Partisë Demokratike Shqiptare

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 31 maj - Seanca e gjashtë e Këshillit të Komunës së Tetovës ka kaluar me disa replika dhe akuza ku më të zëshëm kanë qenë këshilltarët e Aleancës për Shqiptarët, të Lëvizjes BESA, VMRO-së dhe PDSH-së. Këshilltarët kanë patur vërejtje lidhur me punën e Ndërmarrjes Publike Komunale në Tetovë, gjegjësisht gjatë pastrimit të qytetit, larjes së rrugëve dhe rre-

gullimin e punës së tregut të Tetovës. Këshilltari i PDSH-së, Adnan Bilalli, gjatë fjalimit të tij para këshilltarëve, tha se tezgat që janë jashtë tregut duhet të largohen dhe të gjithë shitësit duhet të hyjnë brenda. Ai po ashtu kërkoi të shpeshtohet edhe larja e rrugëve.

"Unë që 60 vjet që jam në këtë qytet. Asnjëherë më keq nuk ka qenë. Në treg nuk ka njeri, është boshatisur, shitet në rrugë, në tezgat jashtë tregut. Kjo nuk është normale për një qytet. A ka inspektorë që kontrollojnë. Pse të mos rregullohet kjo punës, që të gjithë të hyjnë brenda në treg dhe të rregullohet ajo pjesë. Aty shitet gjithçka, papastërti e madhe, shitet mish, ushqime organike, dhe është habi se si nuk ka rënë ndonjë epidemi deri tash", tha Bilalli. Ai më tej tha se është turp që në këtë kohë nuk pastrohen rrugët në qytetin e Tetovës.

"Shumë kontejnerë janë edhe pa rrota, janë të dëmtrar. Është turp për një qytet si Tetova, ku lumi Shkumbin kalon përmes qytetit, ka ujë çdoherë dhe vetëm mungesa e vullnetit ka bërë që të mos lahen rrugët. Nëse u vjen mërzi apo nuk ju punohet atyre atje, le të tregojnë, ka kush punon pa pare, unë vetë do të shkoj do ti mbush cisternat dhe do ti laj rrugët", tha Adnan Bilalli, këshilltar i Partisë Demokratike Shqiptare. Ndërkaq, të njëjtat vërejtje i kanë patur edhe këshilltarët e Aleancës për Shqiptarët, të cilët kërkuan më shumë përkushtim të punës së ndër-

marrjes në higjienën publike.

"Unë jetoj në pjesën qendrore të qytetit të Tetovës dhe ka kohë që nuk kam parë se rrugët janë pastruar apo larë me cisternë. Në raport shkruan se janë pastruar, por ne nuk i kemi parë, prandaj edhe ne si këshilltarë kërkojnë që kjo punë të merret me seriozitet, sepse ka nevojë për pastërti në qytet, kur shohim se ka punëtorë, ka makineri dhe vetëm mungon puna të bëhet", tha Selami. Ai, poashtu nënvizoi se problem janë edhe kontejnerët.

"Ne çdo ditë ballafaqohemi me gjendjen në Tetovë, ku përçolla shqetësimin e qytetarëve, por edhe shqetësimi im është se përgjatë rrugës së Spitalit, shohim kontejnerë të mbushur me mbeturina, por edhe përreth këtyre kontejnerëve ka shumë mbeturina", theksoi Selami. Në ndërkohë, kryetari i Këshillit të Komunës së Tetovës, Bekim Memeti, tha se të gjitha këto vërejtje duhet që ti adresohen autoriteteve përgjegjëse dhe të merren masa në këtë drejtim. Vërejtje këshilltarët e opozitës kishin edhe për shumë pika të rendit të ditës. Në ndërkohë, gjatë seancës u miratua edhe propozim-vendimi për formimin e Komisionit për marrëdhënie ndërmjet bashkësive të Këshillit të Komunës së Tetovës. Po ashtu, në seancën e gjashtë e cila kishte 40 pika të rendit të ditës, u miratua propozim-vendimi për miratimin e planit financiar vjetor të vitit 2018 të shkollave fillore në territorin e Komunës së Tetovës.

Nacionalizmi dhe autoritarizmi rrezik për të ardhmen

Shkup, 31 maj - Ministri i Kulturës, Robert Alagjovzovski, gjatë Forumit Evropian me temë "Evropa - vështrim drejt së ardhmes" që u mbajt në Gdanjskë, Poloni ka treguar sesi nacionalizmi dhe autoritarizmi janë rreziqet kryesore për të ardhmen e përbashkët evropiane, përmes shembujve të qeverisjes autoritare në Maqedoni gjatë dekadës së fundit. Sipas tij, tendencat e tilla janë prezentë në disa vende të BE, ku mungesa e zgjidhjeve politike dhe vendimeve në sferën e ekonomisë, punësimit, standardit rëndom kompensohet me shpërthime narrative nacionaliste, izolacionizëm dhe mbjelljen e frikës dhe urrejtjes ndaj "tjetrit". "Jemi kemi ngecur në gjuhën e frikës dhe kufizimeve, gjuhë e cila nuk e njeh politikën e miqësisë, por politikën e një gjendje të jashtëzakonshme dhe lufte. Dhe si e tillë ajo nuk mund të prodhojë mendim të lirë, vizione të lira, por gropa septike të mbushura me rërën e politikave absurde në të cilat përpëlitimi", ka thënë ministri. Të ardhmen e përbashkët, Alagjovzovski e sheh tek bashkëpunimi intensiv, integrimi i kulturës, pluralizmi kulturor, mbështetja dhe promovimi i dialogut ndërkulturor..., të cilat sipas tij, janë edhe sfidat që i kanë afuar të gjitha vendet për të kontribuar në zhvillimin e rajonit dhe Evropës si një pjesë e përbashkët. Forumi që u mbajt nga 28-30 maj organizohet nga Qendra Evropian e Solidaritetit, në bashkëpunim me ikonën e demokracisë, ish presidentin polak, Les Valensa. (E.H)

Boksieri copëton të dashurën për virgjërinë



Një ngjarje e rëndë ka ndodhur së fundmi në Tajvan, ku një "luftëtar" amator i mori jetën të dashurës, pasi kjo e fundit e

gënjeu se ishte e virgjër.

Gary Chu, 'luftëtar' amator i MMA, ishte njohur me vajzën në internet. Kur zbuloi gënjeshtat e

saj, ai e vrau dhe copëtoi trupin e 27-vjeçares.

Incidenti u filmua nga kamerat e sigurisë të apartamentit, kur Yee-min u pa për herë të fundit. Më pas ishte Gary Chu, i cili u pa në kamera teksa mbante qeska të mëdha. Më 27 maj autoritetet njoftuan se gjetën mbetje të vajzës, teksa Chu u gjet i varur në pemë.

Ai shkroi një postim në Facebook, ku shpjegonte se: Pasi u njohëm në Tinder, ajo më gënjeu duke thënë se ishte e virgjër. Unë u ndjeva i mashtruar dhe i tradhtuar kur kuptova se më kishte gënjyer dhe më mashtronte me meshkuj të tjerë. Ngjarja ka tronditur mbarë opinionin publik.

Gruaja hyn në ashensor, por bie në zbrazëti, vdes në vend

Një ngjarje tragjike është shënuar në Itali, në një pallat në Romë. Një grua humbi jetën pasi u rrëzua në hapësirën boshe të ashensorit. Viktima është një grua 77-vjeçare, e cila duke mos vënë re se mungonte kabina, ra në zbrazëti nga kati i gjashtë. Mbetet ende e paqartë se çfarë ka ndodhur saktësisht dhe se si Elena Pacifici, e cila banonte në katin e parë, ndodhej në të gjashtin. Tashmë do të kryhen të gjitha verifikimet teknike në ashensor, për të zbuluar nëse kishte ndonjë defekt dhe se si dera e hekurt u hap, pavarësisht se kabina nuk ishte në kat, madje ai ndodhej në katin e shtatë. E moshuara e cila prej disa kohësh kishte mbetur e ve, kohëve të fundit jetonte në apartament me të motrën. Aktualisht pritet përgjigja e verifikimeve teknike, në sistemin e hapjes së derve, për të kuptuar nëse ka pasur ndonjë problem, apo dera është hapur me forcë.

Shkon si futbollist në Gjermani, përfundon në burg si shpërndarës droge

Një futbollist profesionist shqiptar, 36 vjeç, me njohje ndërkombëtare kishte ofertë si trajner në Regensburg, por duket që kjo nuk i kishte mjaftuar materialisht. Të martën, 36 vjeçari i cili ishte edhe prind, duhej të paraqitej përpara Gjykatës, për shkak se akuzohet për trafikim të lëndëve narkotike. Sipas aktpadisë, ai ka kryer pazare për tre kilogram kokainë me vlerë 45 mijë euro, dhjetë kilogram marihuanë dhe 500 gram heroinë me vlerë 33.5 mijë euro.

Si ndodhi arrestimi?

Policia përgjonte që prej nëntorit 2017 një lokal në juglindje të qytetit, ku kryesisht frekuentohej nga shqiptarët. Aty mendohej si shitej drogë, shkruan mittelbayerische.de. Policia gjermane vetë filloi biznesin e drogës, me shifrat e lartëpërmendura, për të rënë në gjurmë të shpërndarësve. Përveç personave tjerë, të cilët ndodhen në paraburgim, gjatë trafikimit të drogës ka qenë prezent edhe fut-



bollisti profesionist. Gjykatësi Dr. Wolfhard Meindl dha një dënim për të pandehurin 2 deri 3.5 vjet burg me kusht që ai të rrëfëhet. 36 vjeçari pranoi dhe krahas saj, bëri publik edhe emrat e bashkëpunëtorëve në krim. "I pandehuri kërkonte të sjellte familjen drejt Gjermanisë, për t'u mundësuar një shkollim dhe të ardhme më të mirë," përcjell albinfo.ch. Por ai erdhi në Gjermani për të punuar në një lokal ku u keqpërdor edhe për tregti të paligjshme me drogë. Ai e dinte se bëhej fjalë për drogë. "Por nuk guxoja të veproja ndryshe, pasi rrezikoja lejeqëndrimin në Gjermani," shprehet ai. Procesi gjyqësor vijon akoma.

Vrau babain me çifte



Pas tragjedisë në familjen shqiptare në Zakyntho të Greqisë, duket se fshihen edhe detaje më tronditëse. 26-vjeçari që vrau me çifte babain e tij, mund të jetë viktimë e abuzimit. Ai ishte fëmija i dytë nga martesja e dytë e 70-vjeçarit me një grua shqiptare. Krimi që ndodhi mbrëmjen e 27 Majit, u zbardh ditën e djeshme. 26-vjeçari pranoi krimin që kishte kryer dhe u arrestua për vrasje me dashje dhe armëmbajtje pa leje, shkruan syri.net.

Dyshimet e policisë mbi djalin ranë kur ai dhe mamaja dhanë dëshmi kontradiktore. Këto dyshime u përforcuan akoma më shumë kur 26-vjeçari dhe e ëma nuk morën pjesë në varrimin e 70-vjeçarit. Të mërkurën, autori rrëfeu krimin

dhe u tregoi autoriteteve të tjera informacione të vlefshme për hetimin. Sipas tij, babai kishte abuzuar seksualisht me të për vite me radhë. Madje të njëjtën gjë bëri edhe me motrën dhe vëllain e 26-vjeçarit nga martesja e tretë e babait të tij.

Ai i tha policisë se 70-vjeçari kishte abuzuar me motrën e tij 10-vjeçare dhe vëllain 7-vjeçar. Nëse këto pretendime të tij do të vërtetohen, do të shkaktojnë një skandal në ishullin grek, që u trondit mbrëmjen e së dielës me krimin brenda familjes.

Viktima 70-vjeçar me iniciale P.M. ishte një postier në pension. Ai u gjet i vrarë brenda makinës së tij me plagë në kraharor, fytyrë dhe në krah të shkaktoara nga arma e gjahut.

Vajza nga Shuto Orizari mbahet me dhunë nga një 26 vjeçar

Një ngjarje e pazakont ka ndodhur në lafjen Shuto Orizari të Shkupit. Të mërkurën, në orët e pasmsnatës, në Stacionin Policor në Çair është raportuar për një rrëmbim. Një burrë 53 vjeçar nga Shkupi ka lajmëruar se ditën para-prake, rreth orës 23.50, ka marr një thirrje telefonike nga një mik se ditën e njëjtë e ka parë vajzën e tij 16 vjeçare dukshëm të shqetësuar që po lëviz në një rrugë në lagjen

Shuto Orizari.

Xh.R. është nisur për në vendin e përmendur dhe e ka gjetur vajzën e tij, e cila i ka thënë se me dhunë është mbajtur nga ana e një mashkulli 26 vjeçar në shtëpinë e tij. Ai, sipas rrëfimit të vajzës, nga 18.05.2018 nuk i ka lejuar që ta lëshojë shtëpinë e tij ku e ka torturuar fizikisht.

Po punohet për zbardhjen e tërësishme të rastit.

Përdhunoi fqinjen e mitur dhe e la shtatzënë

Gjykata e Korçës ka shpallur fajtor dhe ka dënuar me 4 vite e 8 muaj burg, Ligor Bibën, i akuzuar për përdhunimin e fqinjes së tij 15-vjeçare dhe lënien e saj shtatzënë. 55-vjeçari ka pranuar fajësinë, vetëm pas analizës së ADN-së të foshnjës, çka provoi autorësinë e abuzimit seksual. Në këtë mënyrë ndërsa Prokuroria kërkoi tetë vite burg për 55-vjeçarin, ai u dënua me 7. Por për shkak të gjykimin të shkurtuar ai përfitoi uljen e 1.3 së dënimit, duke bërë që dënimi përfundimtar të jetë 4.8 vite burg.

Ngjarja u zbulua në tetor të vitit 2017, kur e mitura nga fshati Velçan i Pogradecit, bashkë me prindërit bënë denoncimin në

policia, madje vajza ishte në muajin e tetë të shtatzënisë. Përdhunimi është zbuluar vetëm pasi Xh. Biba është paraqitur tek infermierja e fshatit, sepse kishte dhimbje barku.

Edhe pse 15-vjeçarja shkoi në shkollë, ajo ka arritur ta mbajë të fshehtë një fakt të tillë edhe për prindërit e saj, që, siç thotë, e ka bërë për shkak se kishte frikë dënimit nga opinioni i fshatit dhe babait.

Menjëherë sapo kanë mësuar rreth shtatzënisë, të dy prindërit e të miturës janë alarmuar duke e detyruar t'u tregojë të vërtetën dhe më tej e kanë shoqëruar në komisariatit e Pogradecit për të bërë denoncimin.

Marokeni vret shqiptaren në sy të djalit 5-vjeçar

Një ndarje e cila nuk është pranuar nga ish-burri, ka çuar në vrasjen e një tjetër shqiptareje, në sy të fëmijës. Një shqiptare është vrarë një ditë më parë, në prani të djalit të saj 5-vjeçar, e ndërsa mediat italiane shkruajnë se e ndjera ishte kërcënuar prej autorit.

Shqiptarja 34-vjeçare, Fjoralba Nonaj, që u vra dje në makinë në sy të djalit 5-vjeçar nga ish-burri maroken, ishte kërcënuar me vdekje prej tij, pasi ai nuk pronte ndarjen. Paraprakisht, në këtë pistë janë drejtuar hetimet. Mediat italiane shkruajnë se ata kishin disa muaj që ishin ndarë, por marokeni 35-vjeçar nuk e pronte një gjë të tillë, madje edhe e kishte kërcënuar, shkruan Shekulli. Shqiptarja u qëllua disa



herë me thikë nga burri i saj maroken, 35-vjeçar, ndërkohë që ishin në makinë së bashku me djalin 5-vjeçar. Duke iu referuar informacioneve që japin mediat italiane, krimi është shkaktuar

nga një krizë bashkëshortore, pasi disa muaj me radhë, burri dhe grua nuk kanë jetuar së bashku. Nga kjo tragjedi, fatmirësisht fëmija ka shpëtuar pa asnjë lëndim.

Mëditje e ëmbla mëditje



Nga
Valbona MEHMETI

Pa më shumë bën para, aq më shumë shtohet uria për to, thotë një fjalë e urtë. Politikanët që udhëheqin me shtetin e Kosovës qe gati njëzet vjet, kursesi të ngopen së gjëryeri "minierën" e quajtur buxhet shtetëror. Sindromën e keqpërdorimit të parave të shtetit për lukset personale e kanë përcjellë nga njëra qeveri te tjetra, e kanë rrenjësor thellë në institucionet publike madje edhe tek zyrtari më i thjeshtë.

Duke parë se si udhëheqësit e shtetit udhëtojnë me një duzinë këshilltarësh e asistentësh pas vetes, shijojnë luksin e hoteleve të shtrenjta dhe kthehen nga vizitat jashtë shtetit me xhepat e fryrë nga mëditjet dhe pa ndonjë të arritur konkrete për të mirën e vendit, pse të mos i imitojë ata edhe zyrtari i thjeshtë. Tekefundit, i njëjti ligj ia mundëson edhe atij që të përfitojë nga mëditja dhe me parane publike të shijojë sadopak daljen jashtë një vendi të pazhvilluar ekonomikisht dhe pa liberalizim vizash, siç është Kosova.

Ky ligj apo më saktësisht një rregullore ka 15 vjet që "sharritë" buxhetin dhe u krijon beneficione të paarsyeshme qeveritarëve, deputetëve dhe shërbyesve civilë. Rregullorja e miratuar në vitin 2004, në kohën kur Kosova administrohej nga Misioni i Kombeve të Bashkuara, u mbajt "gjallë" nga të gjitha qeveritë dhe legjislaturat, sepse ishte shumë dobiprurëse për ta. Asnjë parti, asnjë qeveritar apo deputet nuk mori kurrë iniciativë për ta ndryshuar këtë rregullore që përcakton tarifën e mëditjeve për udhëtimet zyrtare jashtë vendit. Kjo tregon se kur vjen puna te përfitimet personale, zyrtarët publikë të të gjitha partive flasin me gjuhë të përbashkët.

Avazin e vazhdon edhe Qeveria aktuale. Zyrtarë të saj i kanë thënë gazetës se kjo rregullore do të mbetet histori sikurse UNMIK-u, por në të vërtetë nuk kanë bërë asnjë hap konkret për ndryshimin e saj. Kanë vazhduar të shfrytëzojnë favorët që i parasheh ajo. Secila parti që ka qenë pjesë e qeverisjes ka ardhur në pushtet me premtimin se do të zvogëlojë shpenzimet për udhëtime, dreka e darka, për telefona e karburante të veturave qeveritare. Por shpenzimet asnjëherë nuk u shkurtuan. Përkundrazi. Trendi i tyre shkoj duke u rritur nga viti në vit.

Raportet e shpenzimeve për udhëtime zyrtare të viteve 2015-2017 tregojnë se nga buxheti i shtetit janë shpenzuar mbi 34 milionë euro, kryesisht në mëditje dhe akomodim. Vetëm në vitin 2017 për udhëtime jashtë vendit janë shpenzuar 4.7 milionë euro, për mëditje mbi 3 milionë euro, akomodim mbi 1.6 milionë euro dhe shpenzime të tjera të udhëtimit 633 mijë euro. Për dreka zyrtare brenda vendit janë shpenzuar 2.9 milionë euro, ndërsa jashtë vendit 25 mijë euro. Shifra të përafërta janë edhe gjatë dy vjetëve paraprakë.

Vetëm në tremujorin e parë të këtij viti, janar-mars, nga buxheti i shtetit për udhëtime zyrtare janë shpenzuar 2.35 milionë euro. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, shpenzimet për këtë kategori janë rritur për 27 për qind, apo nga 1.84 milionë në 2.35 milionë. Këto shifra tregojnë se zyrtarët e shtetit vazhdojnë ta shuajnë pa fije turpi urinë për shëtitje me paratë e qytetarit, i cili ndërkohë vuan pasojat e keqpërdorimeve të tyre, duke u përballur me mungesa të shërbimeve ele-

mentare që duhet t'ia ofrojë shteti e nuk ua ofron.

Dhe sikur nuk u mjafton që shëtisin me paratë e shtetit, deputetë e qeveritarë u bëjnë kërkesa stafit të ambasadave që t'u rezervojnë darka e dreka në objekte turistike dhe ekstravagante. Që mandej t'i postojnë në rrjetet sociale fotografitë që ua dëshmojnë farefisit se sa "larg ka mbërri", se më mirë i njeh vijat ajrore ndërmjet shteteve sesa rrugët e kryeqytetit. Kështu dëshmojnë edhe sesa jofektive janë vizitat e takimet e tyre zyrtare jashtë vendit. Sikur të angazhoheshin më shumë në studimin e materialeve nëpër seminare e trajnime, apo punëtori të hartimit të strategjive, nuk do të kishin kohë as për shëtitje e as për postime. Ndodh e kundërta. Në konferenca e takime shkojnë të papërgatitur, nuk kanë ide as vullnet që të përfitojnë profesionalisht nga to dhe të sjellin praktika të reja në Kosovë, apo të ndërmarrin iniciativa që shtyjnë përpara probleme të qytetarëve. Prania e tyre në ato mbledhje është sa për sy e faqe. Sa për mëditje.

Pikërisht mëditja është ajo që i

Sikur qeveritarët e ligjvënësit kosovarë ta konsideronin të ëmbël shtëpinë e tyre të quajtur Kosovë, do të ndryshonin Rregulloren e tarifave të mëditjeve për udhëtime zyrtare jashtë vendit, do t'i ndalnin keqpërdorimet në emër të saj, do të kursenin buxhetin, dhe me ato para do të investonin në fushat ku qytetarët kanë më shumë nevojë. Por nuk e bëjnë asnjëherë. Për ta më e ëmbël është mëditja



stimulon edhe zyrtarët e thjeshtë të marrin pjesë në trajnime e punëtori që organizohen në shtetet e rajonit, sidomos në Shqipëri. Po të mbaheshin në Kosovë dhe mos t'u jepeshin mëditje nuk do të mund t'i mbanin as brenda në sallë. Sipas tarifës për mëditje të

udhëtimeve zyrtare jashtë vendit, të parashikuar me Rregulloren e UNMIK-ut, një ditë e një zyrtari në Shqipëri kushton 209 euro. Shkaku i kësaj rregulloreje dhe leverdisë nga mëditjet shumica e ngjarjeve zhvillohen në Shqipëri. Rezultate nga seminaret e trajnimet në qytete bregdetare pak e vështirë të priten. Për shkak të jotransparencës dhe mungesës së kontrollit të shpenzimeve, udhëtimet zyrtare dhe mëditjet jo rrallë keqpërdoren nga zyrtarët. Keqpërdorimet me avancat të pambyllura, blerjet e gjësendeve personale me kreditkartela të institucioneve, pagesa për bileta të klasës së parë dhe blerja e biletave në momentet e fundit, janë vetëm disa nga keqpërdorimet që ka evidencuar Auditori i Përgjithshëm gjatë auditimit në institucionet publike. Ndërsa Prokuroria e Shtetit si zakonisht hesht. Asnjë aktakuzë nuk ka ngritur për dyshimet lidhur me këto keqpërdorime.

Përveç keqpërdorimeve për përfitime personale, udhëtimet zyrtare sipas përfaqësuesve të shoqërisë civile nuk kanë sjellë dobi në zgjedhjen e ndonjë problemi të vendit. Ata konsiderojnë se institu-

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 koggio | Data e shtypjes e enjte 31 maj | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

cionet e Kosovës tashmë janë etabluar dhe nuk kanë nevojë më për trajnime jashtë vendit. Sugjerojnë që në vend se të dërgohen dhjetëra njerëz jashtë, do të ishte më mirë që të sillen ekspertë të huaj që do t'u ligjëronin atyre në objektet e institucioneve apo në salla hotelesh të qyteteve kosovare. Kështu do të shkurtoheshin mëditjet dhe shpenzimet e transportit e njëkohësisht do të përfitonin bizneset vendore. Për të ndodhur këto ndryshime së pari do të duhej të ndryshohej Rregullorja 15-vjeçare. Ndryshimi nuk do të duhej të nënkuptonte heqjen e tërësishme të mëditjeve, por përcaktimin më të arsyeshëm të kushteve për ndarjen e tyre.

"Home sweet home" është një shprehje e bukur në gjuhën angleze që në përkthim të lirë në shqip i bie "shtëpi e ëmbla shtëpi" apo "s'ka si shpia jote". Kjo thënie duket se nuk ka aspak rëndësi për qeveritarët e ligjvënësit kosovarë. Sikur ta konsideronin të ëmbël shtëpinë e tyre të quajtur Kosovë, do të ndryshonin Rregulloren e tarifave të mëditjeve për udhëtime zyrtare jashtë vendit, do t'i ndalnin keqpërdorimet në emër të saj, do të kursenin buxhetin dhe me ato para do të investonin aty ku nevojat e qytetarëve janë më të mëdha: shëndetësi, arsim, kulturë e sport. Por ja që nuk e bëjnë asnjëherë. Sepse moti e kanë dëshmuar se më e ëmbël se shtëpia për ta është mëditja. (koha.net)

Manovër mashtruese në Kiev

Rallë përzihet në gëzimin për faktin që dikush jeton edhe kaq shumë habi dhe madje tronditje. Në një mënyrë spektakolare opinioni u gënjeje, duke bërë që tani, pas lajmit se vdekja ishte e sajuar, jo vetëm shumë ukrainas, por edhe mjaft vetë në botë të tundin kokën. Vrasja e supozuar ndaj gazetarit rus kritik ndaj Kremlinit, Arkadi Babtshenko në Kiev ishte një inskenim, pas të cilit fshihej edhe shërbimi sekret ukrainas.

Me gjasë u pengua me këtë një komplot vrasjeje i gazetarit dhe personave të tjerë, që kryhej me porosi të Rusisë, u tha në Kiev. Por provat që shërbimi sekret dhe prokuroria ofruan janë të vakëta. Për shembull një video, se si një organizator i vrasjes arrestohet në rrugë, apo se si shkëmbehen para fshehurazi. Fytyra nuk duken në këto video. Vetëm fjalët dëgjohej. E qartë është që gazetari Babtshenko me vetëdije luajti rolin e statistit në një aksion të shërbimit sekret. Ai lejoi të fotografohej në pellg gjaku. Fotoja pushtoi botën, për të dokumentuar një vrasje, të cilën jo vetëm autoritetet, por edhe politikanë qeveritarë në Kiev për



Autoritetet e sigurisë në Ukrainë i paraqitën botës një krim, që nuk kishte ndodhur, vrasjen e gazetarit kritik ndaj Kremlinit, Arkadi Babtshenko. Vetëm zbardhja e plotë e shpëton tani Ukrainën



20 orë me radhë ia paraqitën botës. Qëllimi i aksionit për të arritur vëmendjen maksimale ishte i dukshëm. Në të njëjtën kohë edhe

një histori e gënjeshtërt, një fake story, që iu servir edhe presidentit federal gjerman, Steinmeier në ditën e vizitës në Kiev nga mikpritësit. Lajmi i keq, që nuk ishte lajmi i vërtetë hodhi hije jo vetëm mbi vizitën në Ukrainë të Frank-Walter Steinmeierit. Besueshmëria e politikës ukrainase si brenda dhe jashtë vendit është vënë tani në provë si asnjëherë tjetër më parë. Sigurisht për të zbardhur vrasje apo penguar ato, janë të nevojshme hetimet dhe ruajtja e sekretit. Kjo vlen edhe më shumë, kur Ukraina prej katër vjetësh ndodhet e ekspozuar ndaj agresionit ushtarak rus, të cilin Kremlini e zhvillon me metoda të rafinuara, kryesisht në Donbas, por edhe me

mashtime politike dhe lajme të rreme. A duhet që Ukraina të kundërpërgjigjet me të njëjtat metoda? Duhet tani të mashtrosh opinionin duke inskenuar edhe vdekjen? Ishte e nevojshme t'i fusesh këtë tmerr zie familjes, miqve dhe të njohurve të Babtshenkos? Çfarë provash të tjera kundër autorëve të dyshuar dhe porositesve në rastin e gazetarit kanë prokuroria dhe shërbimi sekret që e justifikojnë këtë mashtrim? Ukraina duhet të zbardhë këtë rast në mënyrë urgjente, edhe kundrejt vendeve partnere të saj, edhe Gjermanisë. Pas Steinmeierit, shkon për vizitë në Ukrainë, ministri i Jashtëm gjerman, Heiko Maas. Kievi duhet ta përdorë këtë rast.

Nëse kjo nuk bëhet, atëherë imazhi i Ukrainës do të dëmtohet edhe më shumë se tani, kur vendi vuan nga mungesa e reformave dhe ku lufta kundër korrupsionit ka ngecur. Të shpresojmë që politika ukrainase e ka të qartë, se sa po vihet në lojë besueshmëria e saj. Rasti Babtshenka shkaktuar irritime jo vetëm në Ukrainë por në masë të madhe edhe në botë. Këtu mund të ndihmojë vetëm zbardhja e plotë. (DW)



Nga
Bernd JOHANN

100 DITËT E QEVERISË. Vazhdon lufta për ekzistencë materiale

Njëqind ditët e Qeverisë së kryeministri Zoran Zaev, edhe përkundër premtimeve të bollshme për një jetë më të mirë të qytetarëve të Maqedonisë, pothuaj nuk sollën asgjë të veçantë që do të na e ndërronin bindjen se megjithatë - sinjalet japin shpresa dhe se jeta e rehatshme po troket në dyert tona. Së paku jo deri më tani.

Natyrisht, Qeveria ka të drejtë të arsyetohet me kohën e shkurtër sa është në pushtet, megjithatë nuk ka arsytim për mungesën e investimeve kapitale, siç janë grinfild-investimet, nuk ka kapacitete të reja ekonomike e as nuk ka punësime të reja. Përkundrazi, numri i të papunëve vetëm se shohet.

Po kështu, informacionet e ndryshme thonë se shumë brende botërore anashkalojnë Maqedoninë dhe vendosen në fqinjësinë tonë. Arsyet e kësaj, kuptohet, janë



të njohura. Mos anëtarësimi i Maqedonisë në NATO, mos marrja e datës së fillimit të negociatave për anëtarësim në BE dhe problemi me Greqinë janë çështjet kyçe që Maqedonia të konsiderohet si një vend jo atraktiv për investitorët e jashtëm, të cilët për investimet e tyre - kusht kryesor kanë garancitë e qëndrueshme.

Standardi jetësor definitivisht bie, ndërkaq këtë e tregon rritja e çmimeve të produkteve kryesore. Rritja e çmimit të naftës vetëmse

Retorika "DO TA BËJMË KËTË, DO TA BËJMË ATË" është vetëm një mashtrim optik për të ëmbëlsuar zhgënjimin e qytetarëve, të cilët thjeshtë janë shndërruar në "luftëtare" për ekzistencë



do ta bëjë edhe më të pafuqishëm buxhetin familjar. Rritja e rrogës minimale është më pak se një shtim simbolik, ndonëse ka edhe të atillë që thonë se rroga minimale ndodh vetëm për ta blerë qetësinë sociale, por edhe për ta mbajtur në kondicion anëtarësinë partiake.

Të jetuarit sot për nesër, duke i shfrytëzuar kartelat kreditore të bankave, të cilat me kamata të larta janë duke "i rrjepur" qytetarët, gjithsesi nuk do të zgjasë edhe shumë kohë, sepse do të vijë dita kur qytetarët do të ngulfaten nga borxhet, thjeshtë si pasojë ekzistenciale për ta lidhur fillimin me mbarimin e muajit.

Në kontekst të kësaj shtrihet edhe pyetja se ç'u bë me premtimet e subjektit politik shqiptar që participon në Qeverinë e Zaevit? Jo vetëm kësaj radhe, por asnjëherë më parë nuk dimë të jetë realizuar së paku 1 për qind nga programet ekonomike të subjekteve politike shqiptare.

Edhe BDI-ja paraprakisht, në prag të zgjedhjeve parlamentare, premtoi kapacitete të reja ekonomike në vendbanimet shqiptare, por fatkeqësisht asgjë nuk pamë nga ato premtime. Dhe, janë pikërisht shqiptarët që më së shumti ballafaqohen me çështjet ekzistenciale, përkatësisht me sigurimin e kafshatës së bukës.

Retorika "DO TA BËJMË KËTË, DO TA BËJMË ATË" është vetëm një mashtrim optik për të ëmbëlsuar zhgënjimin e qytetarëve, të cilët thjeshtë janë shndërruar në "luftëtare" për ekzistencë. Hapat e premtuar për ndryshime pozitive, tash për tash nuk tregojnë se diçka po lëviz para, përkundrazi - ato vetëm sa nuk tregojnë se me këto hapa po ecim mbrapa.

Njëqind ditët e para të kësaj Qeverie nuk premtojnë se ditët që vijojnë do të jenë të ndritshme për qytetarët e Maqedonisë. Së paku jo nga ajo që dëgjuam e pamë deri më tani.



Nga
Zejnulla VESELI




Republika e Maqedonisë Qeveria e Republika e Maqedonisë

Në bazë të nenit 158-d, 158-gj dhe 158-e e Ligjit për mbikëqyrje të sigurimeve ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 27/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 112/2011, 112/2011, 188/2013, 43/2014, 112/2014, 153/2015, 192/2015 dhe 23/2016), Qeveria e Republikës së Maqedonisë publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për emërim të anëtarit të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për mbikëqyrje të sigurimeve

- Me propozim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë do të emërojë anëtar të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për mbikëqyrje të sigurimeve.
- Organi i Agjencisë për mbikëqyrje të sigurimeve është Këshilli i ekspertëve.
- Këshilli i ekspertëve të Agjencisë përbëhet prej pesë anëtarëve prej të cilëve një është kryetar i cili udhëheqë me Agjencinë dhe e përfaqëson gjatë marrëdhënieve me palë të treta.
- Mandati i anëtarëve të Këshillit të ekspertëve është pesë vjet, me mundësi për rizgjedhje, vetëm se kur ndonjë anëtar i Këshillit të ekspertëve do të ndërpresë të kryejë detyrën para kalimit të mandatit, në emër të tij emërohet person tjetër me mandat deri në kalimin e mandatit të anëtarit që i është ndërprerë kryerja e detyrës.
- Kryetari dhe së paku dy anëtarë të Këshillit, të cilët në bazë të propozimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë i përcakton Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, janë të angazhuar në mënyrë profesionale në Agjenci me orar të plotë të punës dhe nuk mund të kenë funksion tjetër dhe të jenë të punësuar në vend tjetër të punës ose të marrin kompensim tjetër përveç pagesës dhe shtesave tjera të pagesës, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune dhe marrëveshjen kolektive, si dhe kompensimeve nga honorarët e kohëpaskohshëm edukativ dhe autorial.
- Për anëtar të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë mund të zgjidhet personi i cili përmbushë kushtet në vijim:
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - të ketë të mbaruar arsim sipëror;
 - të jetë ekspert i njohur nga sfera e sigurimeve, financat dhe të drejtën tregtare dhe të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e sigurimeve ose financave;
 - të posedojë një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vite: TOEFEL IBT – me më së paku 74 pikë; IELTS – me më së paku 6 pikë; ILEC (Cambridge English: Legal) – me më së paku nivel B2; FCE (Cambridge English: First) – të dhënë ose BULATS – me më së paku 60 pikë dhe
 - të ketë dhënë test psikologjik dhe test për integritet.
- Për anëtar të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë nuk mund të emërohet personi:
 - të cilin i është shqiptuar dënim me burg për veprë penale kundër financave publike, kundër qarkullimit të paguar dhe ekonomisë, kundër detyrës zyrtare ose kundër të drejtës;
 - të cilin i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - i cili është funksionar që udhëheqë me organ shtetëror ose organ të administratës shtetërore;
 - i cili është anëtar i organit për menaxhim, organit mbikëqyrës ose person i punësuar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri të sigurimeve dhe brokerave ose subjekt tjetër juridik mbi të cilin kryen mbikëqyrje Agjencia;
 - i cili është aksionar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri të sigurimeve dhe brokerave, shoqëri për përfaqësim në sigurime ose subjekt tjetër juridik mbi të cilin kryen mbikëqyrje Agjencia;
 - i cili është anëtar i organeve të ndonjë partie politike dhe
 - i cili është deputet ose personi i cili kryen detyrë tjetër ku është emëruar nga Qeveria ose Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.
- Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtrorin dokumentet në vijim:**
 - biografi të shkurtë;
 - certifikatë të shtetësisë;
 - diplomë për arsim sipëror të mbaruar;
 - dëshmi se është ekspert i njohur nga sfera e sigurimeve, financat dhe të drejtën tregtare dhe të ketë së paku pesë vjet përvojë pune në sferën e sigurimeve ose financave;
 - një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatave për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vite: TOEFEL IBT – me më së paku 74 pikë; IELTS – me më së paku 6 pikë; ILEC (Cambridge English: Legal) – me më së paku nivel B2; FCE (Cambridge English: First) – të dhënë ose BULATS – me më së paku 60 pikë;
 - dëshmi për test të dhënë psikologjik dhe test për integritet;
 - dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim me burg për veprë penale kundër financave publike, kundër qarkullimit të paguar dhe ekonomisë, kundër detyrës zyrtare ose kundër të drejtës;
 - dëshmi se nuk i është shqiptuar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
 - dëshmi se nuk është funksionar që udhëheqë me organ shtetëror ose organ të administratës shtetërore;
 - dëshmi se nuk është anëtar i organit për menaxhim, organit mbikëqyrës ose person i punësuar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri të sigurimeve dhe brokerave ose subjekt tjetër juridik mbi të cilin kryen mbikëqyrje Agjencia;
 - dëshmi se nuk është aksionar në shoqëri të sigurimeve, shoqëri të sigurimeve dhe brokerave, shoqëri për përfaqësim në sigurime ose subjekt tjetër juridik mbi të cilin kryen mbikëqyrje Agjencia;
 - dëshmi se nuk është anëtar i organeve të ndonjë partie politike dhe
 - dëshmi se nuk është deputet ose personi i cili kryen detyrë tjetër ku është emëruar nga Qeveria ose Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.
- Dokumentet nga pika 8 duhet të parashtrorin në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter dhe të njëjtat duhet të parashtrorin në Arkivin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë ose përmes postës në adresën: Qeveria e Republikës së Maqedonisë, bul. "Ilinden" nr. 2, 1000 Shkup me shenjë "Për shpallje publike për emërim të anëtarit të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për mbikëqyrje të sigurimeve".
- Afati për paraqitjen e kandidatëve të interesuar është pesë ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes në gazetën ditore, gjegjësisht deri më 7 qershor 2018.
- Dokumentacioni i pakompletuar dhe dokumentacioni i dorëzuar pas afatit për aplikim nuk do të shqyrtohet.



Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) dhe Vendim me nr. 10-317/4 dt. 26.04.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

KOMUNIKATË

për organizimin e Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 10, komuna e Tetovës

Njoftohen qytetarët dhe personat juridik të komunës së Tetovës, se Kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e **Përsëritur të Prezantimit Publik dhe Anketës publike të Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 10 KK Tetovë 1 dhe Tetovë jashtë r. nd., komuna e Tetovës me nr. teknik 2-8/17 i përpunuar nga "URBANPLAN"-SHPK Tetovë.**

Kufiri i përfshirjes planore definohet përmes rr. "Video Smilevski Bato", rr. "159", hekurudha Shkup-Kërçovë dhe në pjesën verilindore kufizohet përgjatë parcelave kadastarale nr. 5707, 5695/4 dhe 1304, me periudhë planore prej 2016-2021 vjet.

Përfshirja është me sipërfaqe prej 8.04 ha.

Brenda përfshirjes planore të bllokut 10, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në ndërtesa banimore, V3 - Kulturë, G4 - Depo, E2 - Suprastrukturë komunale, D2 - Gjelbërim mbrojtës, E1 - Infrastrukturë komunale.

ANKETA PUBLIKE E PËRSËRITUR sipas Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 10, komuna e Tetovës, do të zgjas 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 08.06.2018 –14.06.2018.

Komunikata për prezantimin publik dhe anketën publike është e publikuar në (2) medime publike, në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk dhe në sistemin e e-urbanizmit.

PREZANTIMI PUBLIKI PËRSËRITUR sipas Propozim Planit detal urbanistik për Bllokun Urban 10, në komunën e Tetovës, do të mbahet me dt. 12.06.2018 në ora 11:00, në zyrën nr. 20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Fletat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr. 20 ose në formën elektronike nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë në planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozimet dhe mendimet në fletat anketuese nëpërmjet sistemit informativ e-urbanizëm ose në mënyrë të shkruar.

Shtojca grafike e Planit detal urbanistik në Bllokun Urban 10, do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës dhe në ueb faqen e komunës www.tetovo.gov.mk, informata më detale për Planin detal urbanistik do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,
Teuta Arifi

Në bazë të nenit 35 paragrafi (3) të Ligjit për Planifikim Urbanistik dhe Hapësinor, (G. Zyrtare e RM-së nr. 199/14, 44/15, 193/15, 31/16 dhe 163/16) dhe Vendim me nr. 10-5041/2 nga 10.05.2018 Kryetari i Komunës së Tetovës, e lëshon këtë:

KOMUNIKATË

për organizimin e Prezantimit publik dhe Anketës publike për Dokumentacionin urbanistik planor lokal për parcelën ndërtimore në PK nr. 7689/1, 7690/1 dhe 7691/1 KK Tetovë jashtë r.nd., komuna e Tetovës.

Njoftohen qytetarët e komunës së Tetovës se kryetari i komunës së Tetovës mori Vendim për organizimin e prezantimit publik dhe anketës publike sipas **Dokumentacionit urbanistik planor lokal për parcelën ndërtimore në PK nr. 7689/1, 7690/1 dhe 7691/1 KK Tetovë jashtë r.nd., komuna e Tetovës, i përpunuar nga "URBANPLAN" SHPK Tetovë, me nr. teknik 3-4/16.**

Përfshirja planore gjendet në atarin e qytetit të Tetovës në vendin e ashtuquajtur Klukovë, komuna e Tetovës.

Përfshirjagjendet në pjesën lindore të atarit të qytetit të Tetovës në drejtim të qytetit të Gostivarit pranë rrugës magjistrale A2, në kufi me Bullgarinë (KK Deve Bair) – Kriva Pallankë – Stracinë – Romanovce Kumanovë – Miladinovce – anashkalimi Shkup – Tetovë – Gostivar – Kërçovë – Trebenishtë – Strugë – kufi me Shqipërinë (KK Qafëthanë). Përmes rrugës magjistrale A2 përfshirja lidhet me pjesën e mbetur të Republikës si dhe më gjerë.

Përfshirja është me sipërfaqe prej 11275 m²

Brenda përfshirjes planore të Dokumentacionit urbanistik planor lokal, planifikohen këto klasa themelore të destinimit si në vijim: A1 - banim në ndërtesa banimore, E2 - Suprastrukturë komunale (trafostacioni), E1 - Infrastrukturë komunale.

ANKETA PUBLIKE sipas Dokumentacionit urbanistik planor lokal për parcelën ndërtimore në PK nr. 7689/1, 7690/1 dhe 7691/1 KK Tetovë jashtë r.nd., komuna e Tetovës, me destinim A1 - banim në ndërtesa banimore, do të zgjasë 5 ditë pune, kurse do të mbahet në periudhën nga 08.06.2018 –14.06.2018.

PREZANTIMI PUBLIK sipas Dokumentacionit urbanistik planor lokal për parcelën ndërtimore në PK nr. 7689/1, 7690/1 dhe 7691/1 KK Tetovë jashtë r.nd., komuna e Tetovës, me destinim A1 - banim në ndërtesa banimore, do të mbahet me dt. 11.06.2018 në ora 11:00, në zyrën nr. 20 në Komunë - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Listat anketuese për pjesëmarrje në anketën publike, qytetarët e interesuar mund t'i marrin në hapësirat e Komunës - Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në zyrën nr.20 në komunën e Tetovës ose në formën elektronike përmes sistemit informativ e-urbanizëm.

Në afatin e caktuar qytetarët e interesuar dhe personat juridik nga territori konkret i përfshirë me planin, mund të dorëzojnë vërejtje me shkrim, propozime dhe mendime në listat anketuese.

Shtojca grafike e Dokumentacionit urbanistik planor lokal për parcelën ndërtimore në PK nr. 7689/1, 7690/1 dhe 7691/1 KK Tetovë jashtë r.nd., komuna e Tetovës, me destinim A1 - banim në ndërtesa banimore do të ekspozohet në tabelën e shpalljes në ndërtesën e komunës së Tetovës në ueb faqen e komunës, informata më detale për Dokumentacionin urbanistik planor lokal do të mund të merren në Sektorin e urbanizmit dhe menaxhimit me tokën ndërtimore në komunën e Tetovës.

Kryetar,
Teuta Arifi

IA VRANË KREJT FAMILJEN PARA 19 VITESH

31 maji i vitit 1999 ishte i kobshëm për një familje nga Studimja e Vushtrrisë. 13 anëtarë të familjes Gërxhaliu u vranë për një ditë nga serbët. Shumica nga ta fëmijë. I vetmi që mbeti i gjallë nga kjo familje është Nexhmedin Gërxhaliu. Ai shpëtoi se qëlloi të mos ishte në Kosovë, por jashtë vendit. Por, në këtë masakër që cilësohet si njëra më e tmerrshme gjatë luftës në Kosovë, Nexhmedin u vranë bashkëshortja, djali, nëna, vëllai me bashkëshorte dhe gjashtë fëmijët e tij.

Ata u varrosën nga fqinjët e tij ndërsa kur u kthye pas luftës i ka takuar vetëm në varreza. Sot bëhen 19 vjet nga vrasja e tyre dhe Nexhmedini kujton me dhimbje më të dashurit, të cilët kishte mbetur pa ua dhënë edhe lamtumirën fundit. Malli për ta sa vjen e shohet, teksa kujton bisedën e fundit që e kishte pasur me nënën e tij, Salën.

Nëna e tij ia kishte shprehur shqetësimin për fatin e djalit tjetër Selatinit që ishte ushtar i UÇK-së. Por nuk e kishte menduar se edhe vet ajo do të vdes për një ditë me të.

"Me nanën kom fol së fundi në telefon. Tha: "Nanë ti po don me mbet pa vëlla, unë pa djalë". Që shkojnë komplet familja atë nuk e ka menduar askush. Vëllai ka qenë i veshur, është edhe dëshmor. Por fatin e kishin pas të atillë me shku të gjithë bashkë", rrëfen Nexhmedin Gërxhaliu bisedën e fundit me të ëmën më 30 maj, shkruan Peri-



skopi. Të nesërmen Nexhmedini që gjendej në Holandë kishte mesuar për vrasjen e familjarëve të tij, ndonëse deri kur ka ardhur në Kosovë kishte shpresuar se bëhej fjalë për ndonjë gabim dhe se dikë do ta gjejë të gjallë.

Por, atij askush nuk i doli ta pres në rrugë, përveç motrave të martuara.

"Përkujtim i rëndë. Shumë i rëndë. Ditën e nesërme kam dëgju unë. Kam marrë lajmin tragjik. A ke besu, nuk kam besu, ndonjë kam me e gjet, por fati kish qenë i

atillë që të gjithë kishin shkuar. Kam ardhur me shpresë prej atje, por asnjë se kam gjet. Kam mendu se kam me e gjet një", tregon Gërxhaliu.

Familja Gërxhaliu u vra në shtëpinë e tyre, duke mos i kursyer as fëmijët e vegjël. Më i vogli ishte 7 vjeç ndërsa më i madhi vetëm 15 vjeç. Ai u ekzekutua bashkë me babanë e tij në sokak, ndërsa tjerët u vranë në dhomën ku për çdo ditë kanë shtruar sofrën.

Gërxhaliu shprehet i zhgënjyer edhe për faktin se thotë se dihen

emrat e atyre që kryen masakrën, ndërsa shton se vizitat e tilla verifikuese nga hetuesit janë bërë vetëm sa për formalitet.

"Kanë ardhur thujse çdo vjet. Po a kanë bërë diçka, s'kanë bërë kurrëgjë. Veç pyet, verifiko, provoko a po ndryshohen fjalët, kurrëgjë tjetër. Vitin e kaluar këtu erdhën. Iu thash 'për me pi kafe hajdeni kur të doni, për me m'vet kurrë mos hajdeni se nuk po bëni kurrëgjë. Kështu që hala nuk dihet kurrëgjë. Tek na nuk dihet kurrëgjë. E dinë njerëzit kush ka qenë, por para drejtësisë

nuk ka dalë hala askush", thotë ai.

Edhe pse më nuk jeton në shtëpinë ku iu kishte masakruar familja, Nexhmedini, i shoqëruar nga motra dhe vajza e cila ka lindur pas luftës pasi që Nexhmedini është rimartuar, shpeshherë viziton vendin ku ata u vranë.

Ai mban të vendosura fotografitë e më të dashurve të tij, ndërsa mban të gjallë shpresën që shtëpinë një ditë do ta kthejë në muze.

"Procedura është në komunë. Me ndihmën e kryetarit të ri ndoshta kemi për të ecë përpara. Mandatin e kaluar deri tek Komisioni për Zhvlerësim ka ardhur dhe aty u bllokua puna, nuk kemi ecë përpara. Kam bisedu me kryetarin, ka thënë që është iniciativë e mirë. Të shohin çka po bëhet", tregoi ai.

Sipas tij, periudha e vitit 1999 ishte e pa kohë. Teksa shton se po të përsëritej, sërish do të jepnin gjithçka që kanë për Kosovën.

Familjarët e vranë të Nexhmedin Gërxhaliu janë: Sala Gërxhaliu (1925), Sofie Gërxhaliu (1963), Safer Gërxhaliu (1991), Selatin Gërxhaliu (1950), Fexhrije Gërxhaliu (1960), Sabahudin Gërxhaliu (1992), Abdurrahim Gërxhaliu (1989), Mexhid Gërxhaliu (1988), Muharrem Gërxhaliu (1985), Shaban Gërxhaliu (1985), dhe Shahin Gërxhaliu (1984).

Nga 5 qershori avionë të NATO-s mbi Malin e Zi

Nga 5 qershori, në qiellin e Malit të Zi do ta patrullojnë avionët e dy aleatëve të tij të NATO-s, Italisë dhe Greqisë. Mali i Zi, që iu bashkua aleancës verio-atlantike vitin e kaluar, nuk ka avionë ushtarakë të vetët e për këtë arsye i ka kërkuar NATO-s ta ndihmojnë në garantimin e sigurisë së hapësirës së tij ajrore. Misionet e tilla nuk janë të pazakonta; politikë e aleancës përfshijnë edhe mbrojtjen e qiejve të aleatëve që nuk kanë një forcë ajrore të tyre. Mali i Zi kontribuon nga ana e tij në sigurinë e

përbashkët të aleancës me dërgimin e trupave ushtarake në misionet trajnuese në Afganistan, transmeton tch. Ai siguron po kështu mbështetje financiare për forcat afgane të sigurisë. Avionët luftarakë italianë e ata grekë të përfshirë në këtë iniciativë do të vazhdojnë t'i kenë bazat në vendet e tyre dhe do të ngrihen prej andej sa herë të jetë e nevojshme. Politika ajrore e NATO-s nuk është domosdoshmërisht përgjigje ndaj një kërcënimi specifik, por një element thelbësor i mënyrës sesi garanton sigu-

rinë e pjesëtarëve të saj. Rregullat e aleancës kërkojnë që forcat ajrore të saj të kenë në gatishmëri të paktën dy avionë luftarakë 24/7 dhe në çdo moment pastaj, me dhjetëra avionë të tjerë të jenë në gjendje të ngrihen në ajër kurdoherë në mbarë europën. Spanja, Portugalia dhe Franca janë aktualisht të angazhuara për mbrojtjen e hapësirës ajrore të Lituanisë, Letonisë dhe Estonisë. Italia ndihmon rregullisht në mbrojtjen e qiellit slloven ndërsa forcat ajrore britanikë patrullojnë në Rumani.

Dhunimet në Kosovë Daçiqi i quan propagandë



Në Kosovë po zbatohet një fushatë që për qëllim ka akuzimin e serbëve, që qëllimisht kanë kryer akte dhune ndaj 20 mijë grave shqiptare gjatë luftës atje brenda viteve 1998-1999, deklaroi ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić. "Në Kosovë po zbatohet aksion i planifikuar nga një grup lobistësh, përkatësisht, agjencion marketingu, të cilët duan të shfrytëzojnë synimin që në botë po udhëhiqet lufta kundër dhunës ndaj grave, kundër dhunës seksuale, sidomos gjatë kohës së luftës, prandaj tani në Kosovë ekzistojnë lista dhe peticione ku janë paraqitur mëse 20 mijë gra, të cilat janë dhunuar gjatë luftës në Kosovë, brenda periudhës së viteve 1998-1999", deklaroi Dačić për mediet serbe, transmeton RTK. Tutje, Dačić shtoi se "për të qenë më bindës, lobistët kanë shënjestruar tre emra të njohur të ushtrisë serbe: Miroslav Ulemek-Llegia, Nebojsa Pavkoviç dhe Goran Radosavljeviç-Guri". Sipas Dačićit "pikërisht për këtë shkak, në secilën seancë të KS të OKB-së, ambasadorja e Kosovës, Flora Çitaku, diskuton për dhunën seksuale ndaj grave shqiptare, ndërsa ne na vjen keq disi të gënjejmë, madje edhe për të përmendur viktimat reale". "Natyrisht, nuk e kuptuam se si funksionon rendi i ri botëror", vëren kreu i diplomacisë serbe, Ivica Dačić.

Koloneli italian: Në Kosovë u sëmura nga kanceri

Koloneli i Kryqit të Kuq italian Emerico Maria Laccetti deklaroi për "Novosti" të Beogradit se, pasi ishte kthyer nga misioni në Kosovë, ishte diagnostikuar me "tumor gjigant" në mushkëri. Sipas fjalëve të tij, tumori ka qenë pasojë e drejtpërdrejtë e ekspozimit ndaj rrezatimit jonizues ndaj të cilit ishte ekspozuar në Kosovë. Laccetti ishte kthyer në Romë në korrik të vitit 1999, pasi që me misionin e tij kishte shërbyer për t'i ndihmuar popullatën kosovare. Jo rrallë herë, siç thotë, kishte frymuar pluhur dhe qeliza menjëherë pas bombardimeve. Sipas fjalëve të tij, që në nëntor kishin nisur problemet me frymëmarrjen, ndërsa nga fundi i dhjetorit ishte konfirmuar se ka tumor gjigant. "Më 1 janar u shtrova në spital, ndërsa tri ditë më vonë m'u mor kampion për biopsi. Erdhi diagnoza më e rëndë", rrëfen 55-vjeçari. Më 13 janar masa ia ka mbyl-



lur krejt funksionet e qafës dhe ka nisur t'ia shtypë zemrën, ndërsa pas biopsisë ka nisur me kimioterapi, e cila ka ndikuar mirë te koloneli dhe masa është zvogëluar për 95 për qind. "Ka mbetur 5 për qind e tumorit dhe tani jam nën kontroll të vazhdueshëm, ngase në tumor është gjetur masa tekstualisht 'qeramikë e rrumbullakët', pasojë e radiacionit dhe temperaturave të larta që zh-

villohen gjatë shpërthimit të projektileve të uraniumit të varfëruar i cili, dihet se i takon teknologjisë bërthamore", thotë Laccetti. Ai tregon se ka probleme të mëdha me estrat, se ka protezë në vend të njërës kërdhokull, si dhe me bërrylat dhe shpatullat. Pas një beteje të gjatë juridike, Gjykata e Romës më 2009 ia ka njohur Laccetit statusin e "viktimës së detyrës", ndërsa si shkaktar është cekur ekspozimi ndaj rrezatimit jonizues, ndërsa dëmshpërblim të pjesshëm ka marrë më 2012. Sipas të dhënave të fundit, nga viti 1999 deri sot kanë vdekur 359, ndërsa janë sëmure mbi 4.000 ushtarë italianë që kanë qenë të ekspozuar ndaj uraniumit të varfëruar, ndërsa në mesin e tyre ka shumë që kanë shërbyer edhe në Kosovë, si dhe në Bosnjë e Hercegovinë, Afganistan, Liban dhe vatra tjera të luftës në botë.

KRIZA ITALIANE DHE NDIKIMI MBI EVROPËN

Për herë të parë që nga viti 2014, normat e interesit për obligacionet e qeverisë italiane kanë tejkaluar 3 përqind. Gazeta Die Presse është e alarmuar nga ngjashmëritë midis situatës në Itali dhe asaj të Greqisë tre vjet më parë: "Në të dyja rastet, një rritje e normave të interesit për huatë konsiderohet një ndërhyrje e panevojshme nga jashtë. Në fund, grekët u detyruan të respektonin diktatin e realitetit. Që nga vera e vitit 2015, Tsipras ka zbatuar reformat e kërkuara nga vendet e tjera të BE. Situata po përmirësohet ngadalë; në vitin 2017 ekonomia greke shënoi një rimëkëmbje të konsiderueshme dhe norma e papunësisë ra ngadalë. Por, para se të arrijmë deri në këtë pikë, vendi i vogël që ishte Greqia, e kishte shtyrë Eurozonën në prag të humnerës. Në rastin e ekonomisë së tretë të bashkimit monetar, prova e forcës do të jetë shumë më e vështirë për vendet e tjera evropiane", shkruan Die Presse e Austrisë

ITALIA KA ENDE NJË VEND NË EUROZONË?

Italianët nuk duhet të jenë të vetmit që vënë në pikëpyetje mundësinë e një daljeje, thekson De Volkskrant: "Frustrimi ekonomik i italianëve është i kuptueshëm, ashtu sikurse ngurrimi i votuesve në vendet e tjera për të paguar borxhin e Italisë, injoron të gjitha dispozitat e marrëveshjeve evropiane. Nuk duhet të harrojmë se për vite të tëra, evropianëve u është dashur të



Shtypi eurpian ka analizuar krizën e fundit politike në Itali, si pasojë e mosformimit të qeverisë. Të gjithë autorët janë të mendimit se kriza italia ka ndikim edhe në Europë

shtrengojnë rripat, nën reformat e qeverive të tyre. Në një kohë kur Macron po përpiqet të gjejë kompromis midis Veriut dhe Jugut për çështjen e euros, kriza politike italiane paraqet një debat të një natyre plotësisht të ndryshme: një vend si Italia, që zbaton parimin "shpenzo dhe zhvlerëso", e ka ende vendin e vet në një zonë euro, me

një monedhë shumë të fortë?", vlerëson gazeta holandeze "Volkskrant".

"NËSE BERLUSCONI SHFAQET SI ZGJIDHJE..."

"Novi List", Kroaci ka shkruar se pas pas dështimit të qeverisë së Giuseppe Contes, edhe Silvio Berlusconi do të ishte i preferuar, para këtij kaosi: "Italia ka qenë gjithmonë laborator i Evropës: këtu janë testuar zgjidhje të reja politike. Në këtë laborator, gjërat janë aq të forta, sa ish-kryeministri Silvio Berlusconi, të cilit iu desh të jepte dorëheqjen në kulmin e krizës së euros, duket një garanci për stabilitet dhe moderim. Berlusconi e ka quajtur Lëvizjen 5 vje dhe kërkesën e saj për largimin e Mattarella, të papërgjegjshme. Kush e di, ndoshta Berlusconi është personazhi që do të gjejë rrugëdaljen nga kaosi i tanishëm".

"UDHËHEQËSIT EVROPIANË BI SEDOJNË, NË DËRSA KRIZA PËRKEQËSOHET"

Financial Times beson se dhënia e detyrës Carlo Cottarellit ishte një bast i rrezikshëm për presidentin italian: "Duke ngarkuar me nxitim një tjetër teknokrat jo të zgjedhur, për të udhëhequr një qeveri të përkohshme, Mattarella vetëm sa po forcon partitë anti-establishment. Këto, që janë shumica në të dy dhomat e parlamentit, kishin një mandat të fortë për të formuar një qeveri. Tani ata do të jenë në gjendje të kandidojnë për zgjedhjet e parakohshme, me argumentin bindës se elita italiane, përveç se dorëzohet para të presioneve të Evropës në kurriz të rritjes ekonomike italiane, po punon gjithashtu për të minuar demokracinë".

MATTARELLA MBRON KONTRIBUESIT

Presidenti kishte të drejtë të refuzonte kandidaturën e ministrit të ekonomisë, shkruan gazetari Kostas Giannakidis në gazetën online, Protagon. "Është gjë e mirë, apo jo? Ky është tjetër debat. Presidenti italian mori në konsideratë interesin e vendit, që ishte në rrezik, ashtu sikurse pozicioni i Italisë në Evropë. Por ka edhe një dimension më të thjeshtë dhe më të kuptueshëm: kostoja financiare e këtyre akrobacive populiste. Duke refuzuar kandidaturën e një ministri euroskeptik, Mattarella mbron portofolin dhe normat e interesit të kontribuesve italianë, nga reagimet nervoze të tregjeve. Sigurisht, njerëzit s'mund të qeverisen prej tregjeve. Një argument i mirë, që megjithatë, është i vlefshëm vetëm në një vend të izoluar, si Korea e Veriut" (Bota.al)

Lavrov viziton Korenë e Veriut



Udhëheqësi i Koresë së Veriut, Kim Jong Un, u takua të enjten me ministrin rus të punëve të Jashtme, i cili qëndroi në Phenian në një vizitë në të cilën Moskë shpreu të ritheksojë rolin e saj si një forcë që do të llogaritet përpara takimit të pritur të Kim me presidentin amerikan, Donald Trump në Singapor muajin e ardhshëm.

Moska ka mbetur anash derisa Kim-i shtriu një komunikim të fuqishëm diplomatik me Seulën,

Pekin dhe Washingtonin gjatë disa muajve të kaluar. Por vizita e Sergey Lavrov lë të kuptohet se Rusia dëshiron të sigurohet se është e informuar për synimet e Koresë së Veriut dhe se ajo është e ndërgjegjshme për shqetësimet e Moskës.

Lavrov i përcolli "përshëndetjet dhe urimet më të përzemërta" të presidentit Vladimir Putin për "përpjekjet e mëdha" të Kimit në Gadishullin Korean. Ai gjithashtu shprehu mbështetjen e Moskës për një marrëveshje që Kimi arriti me presidentin e Koresë së Jugut, Mun-Jae-in, në një takim muajin e kaluar, që u përqendrua në masat për të ulur armiqësitë dhe për të rritur shkëmbimet mes dy Koreve.

Ai theksoi mbështetjen ruse për çarmatimin bërthamor dhe përpjekjet për të vendosur paqe të qëndrueshme e afatgjatë në rajon, por tha se Moskë beson që sanksionet mund të lehtësohen derisa zhvillohet procesi, ndryshe nga qëndrimi amerikan se fillimisht duhet të ndodhë çarmatimi bërthamor.

U raportua i vrarë, "ringjallet" gazetari rus

Fotoja përfundoi e vendosur në mur me një shirit të zi! Por tashmë kolegëve u duhet ta heqin sërish. Gazetari rus, Arkady Babchenko, i cili u raportua të ishte ekzekutuar në Kiev gjatë mesnatës mes të martës dhe të mërkurës, i befasoi të gjithë kur u shfaq i gjallë në televizion.

Kreu i shërbimeve sekrete ukrainase, Vasyl Hrytsak u tha reporterëve se "vrasja" ishte inskenuar për të ekspozuar agjentët rusë. "Sipas informacioneve të siguruar nga shërbimi ukrainas i sigurisë, vrasja e gazetarit rus, Arkady Babchenko, ishte urdhëruar nga vet shërbimet ruse të sigurisë", tha Hrytsak.

Babchenko u raportua të ishte gjetur i përgjakur nga bashkëshortja e tij në hyrjen e një blloku apartamentesh ku ata banonin, i qëlluar disa herë me armë zjarri pas shpine, e se kishte ndërruar jetë gjatë transportit me ambulancë për në spital.

Pasi e patën të gjallë në televizion Babchenko, kolegët e tij shpërthyen menjëherë në festë në redaksinë e tyre në Kiev.



Ata nuk kishin asnjë informacion mbi të vërtetën, madje për këtë gazetari nuk kishte njoftuar as ba-

shkëshorten e tij. "Faljen më të madhe dua t'ia dedikoj gruas sime", tha ai.

AUTONOMIA POLITIK-TERRITORIALE E SHQIPTARËVE NË MAQEDONI (4)

SHUARJA E IDESË SË AUTONOMISË DHE KRIJIMI I NJËSIVE USHTARAKE



Nga Qerim LITA

Një ditë më vonë, përkatësisht, më 15 shkurt 1992, Gjyliaz Fejzullahu përmes një letre, në emër të Kuvendit të APTShM-së i shprehte mirënjohjeje kongresistit amerikan Tom Lantosh "për angazhimin e tij dhe paraqitjen e Propozim Rezolutës në Kongresin Amerikan" lidhur me kërkesën për Autonomi Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni. Me qëllim të aktualizimit dhe jetësimit të Autonomisë, udhëheqja e APTShM-së, gjatë muajve shkurt-mars 1992, zhvilloi një aktivitet të gjerë si në këndvështrimin politik poashtu edhe në atë informativ. Në suazat e këtij aktiviteti duhet veçuar botimin e një numri të konsiderueshme të informatave, vështrimeve, intervistave dhe shkrimeve të tjera në shtypin ditor e periodik si brenda hapësirës shqiptare poashtu edhe në botën e jashtme. Përveç kësaj, Kuvendi, më 12 mars, përmes një letre njoftonte dymbëdhjetëshen Evropiane, Lordin Karington, një numër të ambasadeve të shteteve evropiane, SHBA-të, Turqinë dhe Shqipërinë "për pozitën e shqiptarëve në Maqedoni dhe kërkesën për Autonomi Politike Territoriale".

Në kuadër të aktivitetit për jetësimin e Autonomisë shqiptare, nuk duhet harruar qëndrimin disaditor në Gostivar të delegacionit të SHBA-ve, në përbërje: Josef Diogardi, Porkwist Grover, Stefan Wiliam, Osman Osmani dhe Xheksi Sadiku. Gjatë qëndrimit treditor (11-13 mars 1992), delegacioni zhvilloi bisedime të ndara me kryetarin e Forumin Demokratik për të drejtat e njeriut, Milaim Fejziun, me kryetarin e Kuvendit të APTShM-së, Gjyliaz Fejzullahun, me deputetët shqiptar: Neim Selmani, Zudi Bilalli dhe Ferit Sadiku, si dhe me kryetarët e dy partive politike shqiptare, Nevzat Halilin dhe Iliaz Halimin. Ardhja e seri-she të Diogardit, sipas burimeve të kohës "lidhej ngushtë me internacionalizimin e autonomisë shqiptare".

Një aktivitet të dëndur asaj kohe pati edhe "Komisioni për çështje strategjike, i cili ndryshe njihje edhe si "Komisioni për organizimin



Aktiviteti i bujshëm i strukturave udhëheqëse të Kuvendit të APTShM-së, dhe të dy partive politike shqiptare, përcillej në hap nga qarqet e atëhershme qeveritare. Ministria për Punë të Brendshme, përmes një shkrese konfidenciale, njoftonte Qeverinë e R. Maqedonisë se dy partitë shqiptare, PPD dhe PDP, kohëve të fundit po mbajnë kontakte të shumta me krerët e "Alternativës kosovare" (LDK-së), nga të cilët marrin instruksione konkrete për aktivitetet e mëtutjeshme "për institucionalizimin dhe zyrtarizimin e mëtutjeshëm ndërkombëtar të autonomisë shqiptare"

e njësive ushtarake", me të cilin siç u tha më lartë udhëhiqte sekretari i përgjithshëm i PPD-së, Mitat Emini. Ky komision së shpejti rekrutoi një numër të konsiderueshëm të ushtarëve, të cilët u dërguan në Shqipëri për stërvitje, ne mesin e tyre duhet përmendur: Nuri Bexhetin, Halil Palloshin, Sami Golajn, Halil Latifin, Sedat Osmanin, Fatmir Fejzullahun, Orhan Ibrahim, Naser Jakupin, Adem Maksutin, Samet Ibrahimin e shumë të tjerë. Stërvitja e tyre kryhej nën komandën e

Adem Jasharit, i cili në Shqipëri kishte shkuar gjatë muajit nëntor të vitit 1991.

Aktiviteti i dëndur i këtij komisioni përcillej në hap nga shërbimi i atëhershëm sekret UDB-ë. Ministria e Punëve të Brendshme, më 24 shkurt 1992, njoftonte Qeverinë, për disa aktivitete, të cilat kohët të fundit ishin vërejtur në mesin e popullsisë shqiptare, për të cilat kjo ministri dyshonte se bëhet fjalë për krijimin e njësive paraushtarake:

"Sipas disa të dhënave të pakonfirmuara në mesin e popullsisë shqiptare këtyre ditëve po kryhen evidenca për persona me qëllim të formimit të njësive ushtarake të cilët si qëllim primar do ta kenë mbrojtjen e popullsisë shqiptare dhe të organizojnë rezistencë mbarkombëtare të popullsisë në territorin e autonomisë pas pranimin ndërkombëtar të saj dhe fillimin e funksionimit në rast se organet e pushtetit të R. së Maqedonisë do të përpiqen të ndërmarrin çfarëdoj masash represive ndaj popullsisë shqiptare në territorin e saj".

Po i njëjti burim, në mars të vitit 1992 përmes një informate konfidenciale, njoftonte Qeverinë e Maqedonisë, për një organizim ushtarak të shqiptarëve në Maqedoni, i cili veçmas kishte ardh në shprehje "pas realizimit të referendumit për autonomi politike e kulturore të shqiptarëve në R. Maqedonisë". Në të veç tjerash thuhej: "Sipas njohurive të verifikuara, nga na e udhëheqjes së PPD-së dhe anëtarëve ekstrem të kësaj partie, është krijuar ushtria kombëtare shqiptare, me shtabin e

përgjithshëm (komisioni strategjik i PPD-së për mbrojtje) dhe 'shtabet ushtarake' nëpër qytete ku jetojnë qytetarët e nacionalitetit shqiptar. Në kuadër të shtabeve janë krijuar edhe 'komisione' të veçanta të cilët punojnë në përgatitjen e planeve konkrete për aktivitetin e të njëjtëve. Udhëhiqet evidenca ndaj obliguesve ushtarak - persona të cilët pranojnë të radhiten në ushtrinë kombëtare të shqiptarëve, me qëllim që të mund të mobilizohen me kohë". Gjithnjë sipas këtij burimi, Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, e udhëhiqte Mi'that Emini, ndërsa Naxhi Ahmeti, ishte zgjedhur koordinator i përgjithshëm për organizimin dhe për formën e vendosjes së ushtrisë dhe drejtuesit e shtabeve ushtarake të qyteteve të pjesës Perëndimore të R. Maqedonisë edhe atë: për Shkup: Ismet Shabani, Hysen Haskaj, Ismet Berisha, Muhamet Demiri dhe Fatmir Stavileci; për Tetovë - Shinasi Rexhepi, Abdylvehap Ismaili dhe Ilir Luma, për Gostivar - Resmi Ejupi, Selam Elmazi, Samet Huseini, Sejdali Saliu dhe Zudi Bilalli, për Kërçovë - Sejdi Abazi, për Dibër - Eugen Cami dhe Petrit Fetahu, për Kumanovë - Arif Seferi dhe Naim Ibrahim, ndërsa për aktivitetet në botën e jashtme - koordinator të përgjithshëm ishin zgjedhur: në Gjermani Vehap Memishi dhe në Zvicër Shaip Bilalli dhe Xhemal Rexhepi.

Një ngjarje tjetër me peshë historike për shqiptarët në përgjithësi, e për shqiptarët e Shkupit në veçanti, paraqet ardhja e Adem Ja-

sharit dhe grupit të tij në këtë qytet të lashtë shqiptar. Në intervistën e kryer me Ismet Shabanin-Shkupi, kjo ngjarje ka ndodh në dhjetor të vitit 1992 kur forcat ushtarak-polico-re serbe sulmuan kullat e Jasharajve. Sipas tij, Adem Jashari së bashku me Fadil Kodrën, Sami Lushtakun, Sahit Jasharin, Iliaz Kodrën, Jakup Nurën, nën përcjelljen e Milazim dhe Bajram Çiçavicën, vendosen në Shkup në shtëpinë e Ismet Shabanit. Gjatë kohës përderisa Adem Jashari dhe grupi i tij qëndroi tek ai, krejt rastësisht ka ardhur Muj Krasniqi, i cili me ta ka zhvilluar një bisedë të shkurtë dhe më pas është nda nga ata. Për çështje sigurie, Adem Jashari me grupin e tij ishte dashur të qëndrojë plotë 11 ditë te shtëpia e Ismetit, që më pas nën përcjelljen e tij (Ismet Shabanit), kanë udhëtuar për në Dibër të Madhe dhe nga atje ilegalisht e kanë kaluar kufirin për t'u vendosur në shtetin shqiptar. Është me rëndësi të theksohet se edhe kthimi i Adem Jasharit për në Kosovë është kryer përmes Dibër të Madhe, të cilin organizim gjithashtu e ka udhëheq Ismet Shabani.

Aktiviteti i bujshëm i strukturave udhëheqëse të Kuvendit të APTShM-së, dhe të dy partive politike shqiptare, përcillej në hap nga qarqet e atëhershme qeveritare. Ministria për Punë të Brendshme, përmes një shkrese konfidenciale, njoftonte Qeverinë e R. Maqedonisë se dy partitë shqiptare, PPD dhe PDP, kohëve të fundit po mbajnë kontakte të shumta me krerët e "Alternativës kosovare" (LDK-së), nga

të cilët marrin instruksione konkrete për aktivitetet e mëtutjeshme "për institucionalizimin dhe zyrtarizimin e mëtutjeshëm ndërkombëtar të autonomisë shqiptare". Me qëllim të kryerjes sa më profesionale dhe sa më parë të punëve rreth zyrtarizimit përfundimtar të "Autonomisë shqiptare në Maqedoni, - thuhej në informatë - si dhe përgatitjen e materialit në lidhje me kërkesën për ndryshimin e Kushtetutës më datë 15 shkurt 1992 në Gostivar, nga Kosova kanë arritur Esad Stavileci, Zejnulla Gruada dhe dy profesor tjerë nga Prishtina, të cilët në Gostivar duhet të realizojnë kontakt me Gjyliaz Fejzullahun, Neim Selmanin, Mitat Eminin, Nevzat Halilin dhe Iliaz Halimin". Ky grup i profesorëve, siç bënte me dije informata "duhet ta përgatis edhe Projekt-Kushtetutën e Autonomisë", dhe se pas hartimit përfundimtar të këtyre dokumenteve "për ta duhet të njoftohet Bashkësia Evropiane me qëllim të kryerjes së presionit për mospranimin e shtetësisë së R. Maqedonisë". Në fund të informatës, jepej vlerësimi i MPB-së, ku thuhej tekstualisht:

"Sipas vlerësimit tonë, aktivitetet e tilla të separatistëve dhe shovinistëve shqiptarë për 'institucionalizimin' dhe 'zyrtarizimin ndërkombëtar' e të ashtuquajturës 'autonomi shqiptare' janë në kuadër të aktiviteteve të përgjithshme të pjesëtarëve ekstremistë të partive njënacionale shqiptare për ndryshimin e kufijve të R. Maqedonisë, si pjesë e strategjisë globale për krijimin e shtetit të madh shqiptar në Ballkan, që përbën sulm të drejtpërdrejt ndaj rregullimit kushtetues të R. Maqedonisë".

Menjëherë pas kësaj informate, qarqet shoviniste maqedonase, të instaluar brenda qeverisë së atëhershme, nëpërmjet mjeteve të informimit në gjuhën maqedonase e filluan një fushatë të gjerë, e cila për qëllim pati përçarjen e strukturës politike shqiptare. Kësaj fushate iu bashkëngjit edhe Kiro Gligorovi, i cili së shpejti për këshilltar të tij personal, emëroi disa funksionarë të lartë të regjimit të mëparshëm me prejardhje shqiptare, të cilët dolën me tezën se "kërkesa për autonomi", nënkupton se "shqiptarët me vetëdëshirë e pranojnë statusin e pakicës nacionale", prandaj, ajo si e tillë "duhet të hidhet poshtë", dhe njëherit të shkohet me kërkesën "elementit konstitutiv", përkatësisht "shqiptarët, krahas maqedonasve të jenë element shtetformues të Maqedonisë". Njëri prej tyre, madje shkoi aq larg, sa që të merr guximin që para anëtarëve të Kuvendit Qendror të PPD-së, punimet e të cilit u zhvilluan në pranverë të vitit 1992 në Shkup:

"Interesi strategjik i shqiptarëve është që Maqedonia të shkëputet nga Serbia, prandaj ne duhet ta pranojmë pavarësinë e këtij shteti e të insistojmë që shqiptarët në këtë shtet të pavarur, së bashku me maqedonasit të jenë element konstitutiv".

Pikërisht, kjo deklaratë, përkundër faktit se doli nga goja e



UDHËHEQËSIA E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM

Shtabin e Përgjithshëm të Ushtrisë Shqiptare, e udhëhiqte Mi'hat Emiri, ndërsa Naxhi Ahmeti, ishte zgjedhur koordinator i përgjithshëm për organizimin dhe për formën e vendosjes së ushtrisë dhe drejtuesit e shtabeve ushtarake të qyteteve të pjesës Perëndimore të R. Maqedonisë edhe atë: për Shkup: Ismet Shabani, Hysen Haskaj, Ismet Berisha, Muhamet Demiri dhe Fatmir Stavileci; për Tetovë - Shinasi Rexhepi,

Abdyvehap Ismaili dhe Ilir Luma, për Gostivar - Resmi Ejupi, Selam Elmazi, Samet Huseini, Sejdat Saliu dhe Zudi Bilalli, për Kërçovë - Sejdi Abazi, për Dibër - Eugen Cami dhe Petrit Fetahu, për Kumanovë - Arif Seferi dhe Naim Ibrahim, ndërsa për aktivitetet në botën e jashtme - koordinator të përgjithshëm ishin zgjedhur: në Gjermani Vehap Memishi dhe në Zvicër Shaip Bilalli dhe Xhemal Rexhepi.

një njeriu, i cili në atë moment nuk përfaqësonte asnjë forum të asaj partie, apo të ndonjë shoqate joqeveritare shqiptare, krijoi huti brenda strukturës udhëheqëse të PPD-së. Nga procesverbalet e mbledhjes së zgjeruar të Kryesisë Qendrore të kësaj partie, punimet e së cilës u zhvilluan 24 prill të vitit 1992 në Tetovë, informohemi se pjesa më e madhe e deputetëve dhe të ministrave shqiptar u distancuan nga shpallja e Autonomisë, dhe në fjalimet e tyre kërkuan të hedhet poshtë kjo ide, dhe të shkohet, siç do të shprehen "në një opsion më të pranueshëm" për palën maqedonase, e që sipas tyre është "kërkesa për barazi të plotë të shqiptarëve me maqedonasit". Kundër këtij opsioni doli shumica dërmuese e anëtarëve të Kryesisë, si dhe një pjesë e deputetëve, të cilët theksuan se "kërkesa për shpalljen e Autonomisë Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedonisë, përbën një obligim kombëtar i shprehur në mënyrë plebishitare në Referendumin e 11 dhe 12 janarit".

Rrjedhimisht, kjo ide e shpikur nga qarqet qeveritare maqedonase,

e cila si qëllim parësor, pati përçarjen brenda strukturës udhëheqëse shqiptare, e cila asaj kohe ishte e bashkuar si asnjëherë më parë, u reflektua edhe brenda anëtarëve të Kuvendit të APTShM-së. Në Informatën e zgjeruar të Komisionit për Informim të APSHM-së, në lidhje me punën dhe aktivitetin njëvjeçar të Kuvendit dhe të komisioneve të tij, vihej në dukje se "ngadalësimi i aktivitetit të Kuvendit", filloi që në mbledhjen e zgjeruar të datës 30 prill 1992, në të cilën përveç anëtarëve të Kuvendit kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të dy partive politike shqiptare, në të cilën është debatuar për projekt dokumentet: "Propozimi për ngritjen e iniciativës për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë" dhe "Vazhdimësia e elementit shqiptar në Maqedoninë e sotme", për të cilët u bë fjalë më lartë. Në mbledhje për herë të parë në sipërfaqe dolën mendime të ndara për atë se a duhet shkuar në këtë moment "në jetësimin e Autonomisë ose edhe më tutje të vazhdohet me kërkesën për shtetformues" dhe për

rrjedhojë, në mbledhjen e Kuvendit u vendos të zhvillohen konsultime me ekspertët. Një ditë më pas, një delegacion i Kuvendit i udhëhequr nga kryetari Gjyliaz Fejzullahi i shoqëruar edhe nga përfaqësues të lartë të dy partive të atëhershme politike shqiptare, udhëtuan për në Prishtinë me ç'rast zhvilluan një bisedë me ekspertët e njohur shqiptar të fushës juridike, siç ishin: Esad Stavileci, Gazmen Pula, Zejnulla Gruada e tjerë, të cilët shprehën bindjen e tyre se, nuk ka kohë për pritje, porse duhet shkuar urgjentisht në "jetësimin e Autonomisë". Ata, veç tjerash delegacionit të APTShM-së, i sugjeruan që "të përgatitet një kërkesë" e cila do të bazohej në tekstin e projekt dokumentin për jetësimin e Autonomisë, të cilën deputetët shqiptarë duhej t'ia dorëzonin kryetarit Kiro Gligorov.

Nga të dhënat e burimeve autentike të APSHM-së, të cilat me përkushtim janë ruajt nga kryetari i saj, i ndjeri Gjyliaz Fejzullahu, provojnë se sugjerimet e ekspertëve shqiptarë nga Kosova, fare nuk u morën parasysh nga kryesitë e dy partive politike shqiptare, të cilat,

në ndërkohë, hartuan kërkesën, drejtuar Parlamentit, ku kërkohej që "shqiptarëve t'u njihet statusi i shtetformësisë". E njëjta edhe pse u paralajmërua në një konferencë për shtyp, nuk iu dorëzua Parlamentit, ndërsa kërkesa e rekomanduar nga ekspertët, nuk u përgatit fare.

Pikërisht nga ky moment filloi tatëpjeta e jetësimin të Autonomisë Politike-Territoriale të Shqiptarëve në Maqedoni, për arsye se partitë politike shqiptare, në radhë të parë Partia për Prosperitet Demokratik, si parti e cila përfaqësonte mbi 90% të elektoratit shqiptar, fare nuk u angazhua në krijimin e kushteve për vazhdimin e punës së Kuvendit, nuk themeloi fondin financiar të tij, dhe për rrjedhojë ideja për jetësimin e APTShM-së u shua fare. E gjithë kjo krijoi pakënaqësi dhe huti tek shqiptarët. Shumë degë të PPD-së si brenda ashtu edhe në botën Perëndimore, përmes reagimeve dhe protestave të shkruara, kërkuan sqarim se "përse ngecin aktivitetet rreth jetësimin të Autonomisë". Pyetje të kësaj natyre, thuhet në një dokument të hartuar nga Kuvendi i APTShM-së "shtrihen si në kohë ashtu edhe në hapësirë", si nga qytetarët ashtu edhe nga asociacione apo subjekte të ndryshme, për çka "me plotë përgjegjësi - thuhej në fund të dokumentit - konsiderojmë se përgjigje duhet të japin dy partitë politike PPD-ja dhe PDP-ja, me grupin parlamentar në Krye".

Heqja dorë nga jetësimi i Autonomisë, u shfrytëzua maksimalisht nga pushteti i atëhershëm maqedonas, i cili së shpejti morri masa represive ndaj popullsisë shqiptare në përgjithësi, e te një pjesë e strukturës udhëheqëse shqiptare në veçanti, siç ishin rastet në Bit Pazar, Ladorisht, Afera e Armëve etj.

Këtë vështrim të shkurtër historik, kushtuar çështjes shqiptare në trevat etnike në R. Maqedonisë, mi-dis harkut kohor 1990-1992, e pash të arsyeshme ta përfundoj duke iu referuar një pjese të intervistës së kryetarit historik të Kuvendit të APSHM-së, intelektualit dhe atdhetarit të devotshëm, të ndjerit Gjyliaz Fejzullahu, dhënë gazetarit të gazetës Bujku - Prishtinë, Ismail Arslanit, me rastin e njëvjetorit të Referendumit për themelimin e Autonomisë shqiptare në këto treva etnike:

"Besoj se për këtë nuk duhet menduar shumë. Dihet mirëfilli se cilat janë përparësitë e statusit shtetformues. Shtrohet pyetja: cilat janë argumentet që kjo të realizohet. Pushteti maqedonas nuk është aq naiv që më shumë reagon kur përmendet referendumi e autonomia, kurse më pak kur fjala për statusin e shtetformuesit. Sa i përket Autonomisë Politike-Territoriale, mund t'i potencoj qëndrimet e ekspertëve. Elementi shtetformues - po, mirëpo pa mekanizëm mbrojtës (konsensus) nuk do të ishte asgjë, kurse element shtetformues pa territor të caktuar, përkatësisht Autonomi, nuk mund të ketë".

(fund)



JAVËN TJETËR ZBARKON NË ÇAIR

BILALI, PËRFORCIMI I PARË I FC SHKUPI

Sipas burimeve të gazetës KOHA, Amir Bilalli do të jetë përforcimi i parë i FC Shkupi. 24 vjeçari nga Gostivari ka arritur marrëveshje me drejtuesit e klubit, ndërsa javën tjetër pritet që kjo marrëveshje të zyrtarizohet dhe ai të prezantohet para mbështetësve të skuadrës nga Çairi. Bilali luan në pozitën e mbrojtësit dhe së fundmi ishte pjesë e skuadrës së Teutës nga Durrësi

Koha Bujar KURTAJ

Shkup, 31 maj - FC Shkupi pasi edhe zyrtarisht ka marrë dritë jeshile për të garuar në Liga Evropë, drejtuesit e klubit kanë filluar të hartojnë edhe planin e përgatitjeve verore. Këtë gjë ata e pohuan në iftarin e shtruar për gazetarët sportiv të mërkurën. "Kemi oferta të majme



nga Sllovenia, Italia, Zvicra, por edhe nga Turqia për të shkuar edhe për ti realizuar përgatitjet verore. Në këtë pjesë të fundit është oferta nga kampi i Fenerbahçes, në të cilët mund të përgatiten futbollistët tanë me ata të skuadrës së mirënjohur turke", tha pronari i FC Shkupit, Shefshet Demiri. Ai gjithashtu ka folur edhe për përforcimet e mundshme. "Në koordinim me trajnerin Zekirja Ramadanin dhe drejtorin sportiv Omer Bunjaku, jemi duke rishqyr-

tuar përforcimet e radhës në merkaton e verës, derisa ende jemi në bisedime me disa nga lojtarët aktual për vazhdimin e bashkëpunimit. Sa i përket përforcimeve, konkretisht nuk ka asgjë dhe në momentin që do të konfirmojmë ndonjë, do të jeni të informuar me kohë, deklaroi Demiri, me ardhjen e të cilit, FC Shkupi po rikthehet në shtigjet e vjetra. Mirëpo, sipas burimeve të gazetës KOHA, Amir Bilalli do të jetë përforcimi i parë i FC Shkupi. 24 vjeçari nga Gostivari ka

arritur marrëveshje me drejtuesit e klubit, ndërsa javën tjetër pritet që kjo marrëveshje të zyrtarizohet dhe ai të prezantohet para mbështetësve të skuadrës nga Çairi. Bilali luan në pozitën e mbrojtësit dhe së fundmi ishte pjesë e skuadrës së Teutës nga Durrësi. Cekim, para disa ditëve klubi nga Çairi konfirmoi se ka vazhduar kontratat me pesë futbollist, kapitenin Suad Zendeli (një vit), Bllazhe Ilijoski (deri më 2020), Muharem Bajrami (2020), Bllagoja Lamçevski



Shefshet Demiri

Kemi oferta të majme nga Sllovenia, Italia, Zvicra, por edhe nga Turqia për të shkuar edhe për ti realizuar përgatitjet verore. Në këtë pjesë të fundit është oferta nga kampi i Fenerbahçes, në të cilët mund të përgatiten futbollistët tanë me ata të skuadrës së mirënjohur turke

(2020) dhe Alen Jasharovski (2020). Derisa, kanë mbetur vetëm detaje për të përfunduar marrëveshjet edhe Kristijan Stojkoski, Stefan Vujić, Ermedin Adem, Edis Maliqi dhe Bunjamin Shabani. Ndërkohë, futbollistët e FC Shkupi janë në pushim të merituar, ndërsa procesit stërvitor do ti rikthehen më 6 qershor kur është caktuar grumbullimi zyrtar për sezonin e ri, respektivisht garat e "Europa League"



Lotito "blindon" Taren

Prej shumë kohësh emri i Igli Tares qarkullon në ambientet sportive shqiptare si kandidat potencial për të marrë drejtimin e FSHF-së. Vetë Tare e ka refuzuar këtë mundësi për momentin, ndonëse ka shprehur shpesh dëshirën që në të ardhmen të ulet në stolin e përfaqësueses shqiptare. Megjithatë, mos pritni që kjo të ndodhë së shpejti. Drejtuesi shqiptar i Lacios është shumë pranë rinovimit me Lacion dhe me marrëveshjen e re, klubi është gati ta "blindojë" për një kohë të gjatë. Sipas mediave italiane, shumë shpejt Tare do të firmosë një marrëveshje 5-vjeçare, sigurisht me përmirësime të ndjeshme të kushteve financiare, ashtu si edhe me shumë fuqi vendimmarrje, meqë presidenti Lotito i beson atij verbërisht. Në këtë mënyrë, Lacio do të largojë edhe çdo "pretendent" nga klubet e tjera italiane të cilat kanë hedhur sytë nga Tare, si dhe do të bëjë shumë më pak të mundur kthimin e tij në Shqipëri, për një rol drejtuesi në futbollin tonë, apo për të realizuar ëndrrën e tij që të ulet në bankinën kuqezi.

Dështon miqësorja me Iranin

Dështon për Kosovën edhe miqësorja me Iranin, që mendohej se do të zhvillohen në Stamboll. Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri, konfirmoi nëpërmjet një lidhje të drejtpërdrejtë për "Sport News", që nuk ishin kushtet e përshtatshme për këtë test, ndaj pas konsultës me trajnerin Shallandes është vendosur që "Dardanët" ta mbyllin pa një miqësore të dytë këtë grumbullim. "Nuk do të luhet ndeshja me Iranin, vendimi është marrë në konsultim me trajnerin Challandes. U vumë disa kushte sportive organizatorëve, që nuk u pranuan. Na kërkuan të luanim në Stamboll, pa tifozë, por ne i ndërpreme bisedimet. Kosova do të qën-



drojë edhe dy ditë në grumbullim dhe që nga e shtuna futbollistët do të shpërndahen. Të shtunën ose të dielën do të

kthehemi në Kosovë", deklaroi Vokrri. Cekim, të martën, Kosova mundi me 3-0 kombëtaren e Shqipërisë.

Shqipëri - Ukrainë megjithatë do të luhet

FIFA ka marrë vendimin me ndeshjen midis Shqipërisë dhe Ukrainës. Disa ditë më përpara trajneri i Ukrainës, Andrej Shevçenko nëpërmjet një konference për shtyp bëri me dije se ndeshja miqësore

me Shqipërinë nuk do të zhvillohet, për shkak se stadiumi ku do të mbahet është i përmasave të vogla për një ndeshje midis kombëtaresh. Ndesha do të zhvillohet më 3 qershor në stadiumin e Evianit, të cilin

Ukraina e cilëson si një impiant të vogël. Shevçenko dhe Panuçi kanë shfaqur pakënaqësi për stadiumin, pasi nuk ka një tribunë të mirëfilltë tifozësh. Por kjo ankesë nuk ka shërbyer për asgjë, pasi FIFA nuk e ka marrë parasysh dhe ka vendosur që sfida miqësore edhe pa preferencën e trajnerëve do të zhvillohet në këtë stadium. Ndërkombëtarët mendojnë se të dyja palët duhet të respektojnë kontratën. Është konfirmuar zyrtarisht për herë të dytë që sfida do të zhvillohet ditën e diel në orën 16:00 në stadiumin e Evianit në Francë. Në rast se Ukraina vendos të bojkotojë sfidën do i duhet të paguajë një dëmshpërblim të rëndë.



Në bazë të nenit 116 paragrafi 5 dhe nenit 123 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Gazeta Zyrtare e RM: 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 21/18) si dhe nenit 29 paragrafi 5 dhe nenit 36 të Statutit të IPKÇF "Rada Poceva" Kavadar, ndërsa në pajtim me Vendimin për publikim të shpalljes publike për zgjedhje të drejtorit nr. 10-2829/2 të datës 28.05.2018 të sjellë nga ana e Kryetarit të Komunes së Kavadarit, Këshilli Drejtues i IPKÇF "Rada Poceva" Kavadar publikon:

SHPALLJE PUBLIKE

Për zgjedhje të drejtorit të IPKÇF "Rada Poceva" Kavadar

Për drejtor të IPKÇF "Rada Poceva" Kavadar mund të emërohet gjegjësisht të zgjidhet personi i cili krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me ligj edhe kushtet e caktuara në nenin 142 të këtij ligji është me arsim sipëror (me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar) dhe plotëson kushtet të caktuara në nenin 136 të këtij ligji për edukator, bashkëpunëtor profesional, person me fakultet të mbaruar filologjik – programi studimor mësimor dhe studime të specializuara për pedagogë parashkollor, jurist, sociolog dhe ekonomist me arsim sipëror të mbaruar (me 240 kredi të arritura sipas SETK ose shkallë të VII/1 të mbaruar) dhe minimum pesë vjet përvojë pune pas diplomimit, posedon një prej certifikatave të njohura ndërkombëtare ose certifikatë për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet TOEFEL IBT – së paku 74 pikë, IELTS – së paku 6 pikë, ILEC (Cambridge English: Legal) – së paku niveli A2, FCE (Cambridge English: First) – të dhënë, BULATS – së paku 60 pikë ose APTIS – së paku niveli B2, dhe posedon licencë valide për drejtor të institucionit për fëmijë.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- CV (biografia e kandidatit),
- dëshmi për arsimin e mbaruar sipëror (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- certifikatë të shtetësisë,
- dëshmi për përvojë pune,
- certifikatë të mjekut

- të posedojë licencë valide për drejtor të institucionit për fëmijë.

- vërtetim se nuk i është shqiptuar dënimi me vendim të plotfuqishëm gjyqësor me të cilin është dënuar për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim të personit të mitur ose abuzim farefisnor, për vepër penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht të sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është caktuar sjellje diskriminuese.

- vërtetim se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

- Kandidati për drejtor të institucionit për fëmijë obligohet të parashtrojë edhe program për punë të cerdhes për fëmijë.

Kushtet për posedim të certifikatës së njohur ndërkombëtare ose certifikatës për njohje aktive të gjuhës angleze jo më të vjetër se pesë vjet do të aplikohen prej më 1 shtator 2018.

Kandidati i cili zgjidhet për drejtor obligohet që të përmbushë kushtin për njohje të gjuhës angleze më së voni në afat prej një viti duke konsideruar nga dita e zgjedhjes. Drejtori zgjidhet gjegjësisht emërohet për kohë prej 4 vjet.

Shpallja zgjatë 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.

Zgjedhja do të realizohet nga ana e kryetarit të komunës në afat prej 15 ditëve nga dita e marrjes së propozimit nga Këshilli drejtues.

Dokumentet e nevojshme të dorëzohen deri te Këshilli drejtues i IPKÇF "Rada Poceva" Kavadar rr. "Braça Xhunovi" nr. 11a, me shenjë për "Shpalljen publike për zgjedhje të drejtorit".

Dokumentet e paplotësuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Këshilli drejtues
Kryetar
Sijka Llazova

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15-tekst i pastruar) nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 11/18) dhe Pëlqimit nr. 18-6242/2 të datës 29.05.2018, nga Ministria e financave dhe nenit 12, nenit 16 paragrafi 1 dhe 2, e Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "Rada Poceva" – Kavadar, U.D Drejtori i Institucionit publikon

SHPALLJE PUBLIKE PËR PUNËSIM PËR KOHË TË CAKTUAR TË PUNËS

1. Një (1) person për vendin e punës përkëdhelës – ofruer i shërbimeve nga niveli i parë G për kohë të caktuar të punës, Krahas kushteve të përgjithshme për punësim në institucion për fëmijë të parapara me nenin 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Tekst i konsoliduar dhjetor 2017).

Kushtet e përgjithshme që vlejën për të gjithë kandidatët:

- Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë (jo më të vjetër se 6 (gjashtë) muaj),
- Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik,
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor që dënohet për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim me person të mitur dhe abuzim farefisnor, për vepër penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese

Kandidatët për vendin e punës përkëdhelës duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- arsim të mesëm të mbaruar katërvjeçar,
- licencë valide për përkëdhelës,
- me dhe pa përvojë pune,

Marrëdhënia e punës themelohet për kohë të caktuar për periudhë deri më 31.12.2018.

Orari ditor i punës është prej ora 08:30-16:30 prej të cilave 7 orë pune me fëmijë, dhe pjesa tjetër e orarit të punës parashihet për aktivitete tjera dhe përgatitje

Neto pagesa fillestare për vendin e punës: 14.000,00 denarë

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit. Dokumentet që arrijnë të paplotësuara nuk do të merren parasysh.

Kandidatët e interesuar për marrje të më shumë informatave mund të drejtohen në numrin e telefonit 043/412-097, ndërsa aplikacionet e tyre mund të parashtrojnë në arkivin e IPKÇF "Rada Poceva" Kavadar, rr. "Braça Xhunovi" nr. 11a (çerdhja qendrore).

IPKÇF "Rada Poceva"
U. D Drejtor,
Cana Dobrinova

Shpallje

Shitet shtëpia në Gazi Babë me sipërfaqe prej 100m², posedon 4 dhoma, bodrum dhe oborr, e rinovuar në gjendje shumë të mirë, çmimi 52.000 euro me mundësi për marrëveshje kontakt tel. 078-353-988

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221



VACANCY ANNOUNCEMENT

The Office of UN Women is seeking motivated and creative professionals for the position of Programme Specialist.

Programme Specialist

Under the direct supervision of the Director and Deputy Director of the Europe and Central Asia Regional Office, and working in close consultation with the Resident Coordinator [RC] the Programme Specialist will be responsible for the following:

- Design and develop programme strategies for the programme office
- Manage the implementation and management of the programme office
- Manage technical assistance and capacity development to project/programme partners
- Manage the monitoring and reporting of the programme/ project
- Manage the people and financial resources of the programme office
- Build partnerships and support in developing resource mobilization strategies
- Contribute to inter-agency coordination to achieve coherence and alignment of UN Women programmes with other partners in the Macedonia
- Manage advocacy, knowledge building and communication efforts

Required education: Master's degree or equivalent in social sciences, human rights, gender/women's studies, international development, or a related field is required. A first-level university degree in combination with two additional years of qualifying experience may be accepted in lieu of the advanced university degree.

Required professional experience: At least 5 years of progressively responsible work experience at the national or international level in design, planning, implementation, monitoring and evaluation of development projects; Technical experience in programming related to the office; Experience coordinating and liaising with government agencies and/or donors is an asset; Experience working in the UN System is an asset; Experience in leading/managing a team is an asset.

Language Requirements: Fluency in English and Macedonian is required. Working knowledge of another official UN language is an asset.

Duty station: Skopje

Interested candidates should submit their applications on-line, through the UNDP Web site www.undp.org.mk. The deadline for submission of application is 14 June 2018. For further requirements, detailed Terms of Reference and a copy of the UN Personal History form (P-11) are available on UNDP Web site www.undp.org.mk. Applications received after the closing deadline will not be considered.

Organ i KB për barazi gjinore UN Women publikon pozitën e lartpërmendur.

Në bazë të nenit 14 paragrafi 1 dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 167/15-tekst i pastruar) nenit 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17 dhe 11/18) dhe Pëlqimit nr. 18-5253/2 të datës 29.05.2018, nga Ministria e financave dhe nenit 12, nenit 16 paragrafi 1 dhe 2, e Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në IPKÇF "Rada Poceva" – Kavadar, U.D Drejtori i Institucionit publikon

SHPALLJE PUBLIKE PËR PUNËSIM PËR KOHË TË PACAKTUAR TË PUNËS

1. Një (1) person për vendin e punës person për larje-hekurosje – person tjetër ndihmës-teknik nga niveli i parë A1 për kohë të pacaktuar të punës, Krahas kushteve të përgjithshme për punësim në institucion për fëmijë të parapara me nenin 142 të Ligjit për mbrojtje të fëmijëve (Tekst i konsoliduar dhjetor 2017),
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
 - Të njeh gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik,
 - Të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,
 - Të mos i jetë shqiptuar dënimi me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor që dënohet për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim me person të mitur dhe abuzim farefisnor, për vepër penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese

Kandidatët me fletëparaqitjen duhet të parashtrojnë edhe dokumentet në vijim për vendin e punës person për larje-hekurosje:

- Diplomë për mbarim të arsimit fillor ose të mesëm katërvjeçar (origjinal ose kopje të vërtetuar në noter)
- Certifikatë të shtetësisë,
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi me aktvendim të plotfuqishëm gjyqësor që dënohet për vepër penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes dhe keqtrajtim me person të mitur dhe abuzim farefisnor, për vepër penale nga grupi i veprave kundër lirisë gjinore, pavarësisht sanksionit të shqiptuar dhe tek i cili në pajtim me ligjin është përcaktuar sjellje diskriminuese
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar dënimi ose sanksion kundërvajtjes ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

Orari ditor i punës është prej ora 06:00-14:00

Neto pagesa fillestare për vendin e punës: 12.000,00 denarë

Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit. Dokumentet që arrijnë të paplotësuara nuk do të merren parasysh.

Kandidatët e interesuar për marrje të më shumë informatave mund të drejtohen në numrin e telefonit 043/412-097, ndërsa aplikacionet e tyre mund të parashtrojnë në arkivin e IPKÇF "Rada Poceva" Kavadar, rr. "Braça Xhunovi" nr. 11a (çerdhja qendrore).

IPKÇF "Rada Poceva"
U. D Drejtor,
Cana Dobrinova

Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 - Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m² oborr dhe 116m² objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

BENZEMA GODET PRESIDENTIN E FEDERATËS FRANCEZE

ZBULUAT FYTYRËN TUAJ TË VËRTETË

Le Graet u pyet për mungesën e Benzema në radhët e Francës për Kupën e Botës në një intervistë të fundit dhe, pavarësisht se nuk donte të komentonte mbi situatën, ai mendonte se Franca tani luan një "stil të lojës dhe nuk mund të kthehemi pas". Komentet e tij nuk i shpëtuan vëmendjes së Benzema të zemëruar



Karim Benzema goditi presidentin e Federatës Franceze të Futbollit (FFF), Noel Le Graet, se ka treguar fytyrën e vërtetë të tij, duke mbështetur vendimin e Didier Deschamps për ta lënë sulmuesin e Real Madridit jashtë skuadrës së Francës për Kupën e Botës. 30-vjeçari nuk është thirrur nga kombëtarja e vendit të tij që nga tetori i vitit 2015, pasi është hetuar në lidhje me një përpjekje të dështuar për të shantazhuar

shokun e tij ndërkombëtar, Matieu Valbuena. Edhe pse Deschamps në të kaluarën ka sugjeruar se dera nuk është e mbyllur për Benzema, mungesa e vazhdueshme e tij, shpesh ka ngritur pyetje. Le Graet u pyet për mungesën e Benzema në radhët e Francës për Kupën e Botës në një intervistë të fundit dhe, pavarësisht se nuk donte të komentonte mbi situatën, ai mendonte se Franca tani luan një "stil të lojës dhe nuk mund të

kthehemi pas". Komentet e tij nuk i shpëtuan vëmendjes së Benzema të zemëruar. Ai shkroi në logarinë e tij zyrtare në "Twitter": "z. Le Graet, me gjithë respektin, ju keni humbur një mundësi për të heshitur. Kam zbuluar fytyrën tuaj të vërtetë dhe kjo nuk është ajo që më keni thënë, që më keni vlerësuar ballazi. Më mirë të mos diskutojmë më për temën e përzgjedhjes në ekipin kombëtar", shkroi Benzema. Franca e fillon Kampionatin Botëror të Rusisë duke luajtur kundër Australisë, më 16 qershor, në Kazan, por së pari do të trajtojë miqësoren me Italinë, këtë javë. Benzema ka luajtur 81 herë për ekipin kombëtar francez dhe ka shënuar 27 gola. Nga skuadra aktuale e "Les Bleus", vetëm Olivier Zhirud ka shënuar më shumë gola për kombëtaren e tij.

Dua një lamtumirë si ajo e Iniestës

Portieri aktual i Portos, Iker Kasillas ka folur në një eveniment dhe është shprehur se do të kishte dashur një lamtumirë te Real Madridi, si ajo e Iniestas te Barcelona. "Jam i sigurt se në të ardhmen do të ketë një pajtim. Nuk jam xheloz, fatmirësisht akoma po luaj futboll, kam gjetur një vend ku jam i lumtur dhe nuk jam në faqet e para të gazetave. Të gjithë do të kishim dashur një lamtumirë si ajo e Iniestas. Jam i lumtur për kolegët e mi", shprehet Kasillas. "Sa herë që jam në Madrid, shkoj në 'Bernabeu' për t'i mbështetur. Jam 37 vjeç dhe 34 prej tyre kam qenë tifoz i tyre. Një rikthim te klubi, nuk i dihet. Kam luajtur për një kohë të gjatë te Madrid. Nëse më telefonojnë normalisht që do të kthehem. Por për momentin jam akoma duke luajtur futboll, mbase në të ardhmen", deklaroi Kasillas.



Babai nuk vendos për karrierën time



Neymar ka lavdëruar babanë e tij, por këmbënguli se i merr vetë vendimet në lidhje me të ardhmen e tij. Neymar ka qenë i lidhur me një lëvizje drejt Real Madridit, pas vetëm një sezoni në PSZH, ku arriti për një shifër rekord prej 222 milionë euro nga Barcelona, vitin e kaluar. Babai i 26-vjeçarit ka vepruar si këshilltar i tij dhe, gjithashtu, shërben si agjent i të birit, por Neymar Jr tha

se çdo vendim për karrierën ishte në duart e veta. "Babai nuk merr vendime për karrierën time. Unë jam ai, që vendos për këtë, - i tha sulmuesi i njohur revistës braziliene "VIP". "Ai është këshilltari më i mirë që mund të kërkoj, por, në fund, është vendimmarrja ime. Babai kujdeset për çështje të tjera, që shkojnë paralelisht me futbollin, kështu që mund të përqendrohem vetëm në profesionin tim", deklaroi ylli brazilian. Neymar shënoi 28 gola në sezonin e tij të parë te PSZH-ja dhe kontribuoi me 18 asistime. Fushata e tij përfundoi më herët nga një dëmtim në këmbë, që pësoi në ndeshjen kundër Marsej, në shkurt. Megjithatë, ai po bëhet gati për kombëtaren e Brazilit në Kupën e Botës së Rusisë 2018, ku do të luajë në Grupin E kundër Zvicrës, Kosta Rikës dhe Serbisë. Në të vërtetë, shokët e tij janë optimistë në lidhje me mënyrën se si ai po shërohet, me Danilo duke deklaruar se Neymar po bëhet më i mirë dhe më i shpejtë çdo ditë.

Publicitet

TIFOZI RUS ME POROSI PËR TIFOZËT ANGLEZ

Nëse sillen mirë, unë do t'u jap dorën



Një lider tifozësh rus i futur në burg për shkak të sherreve me tifozët anglezë në Euro 2016 ka thënë se ai dhe tifozët e tjerë janë paralajmëruar nga policia nëse tregohen të dhunshëm në Kupën e Botës. Gorbaçev ka kaluar shtatë muaj në një burg të Marsej pas përplasjes të tifozëve të Anglisë dhe Rusisë dy vite më parë në Francë, ku janë hedhur grushte, shishe dhe tymëse. Autoritetet ruse kanë premtuar ta ndalin dhunën në Kupën e Botës. Sergei Gorbaçev pranon se kishte marrë pjesë gjithashtu në takimet me policinë në të cilën tifozët janë thënë të mos angazhohen në dhunë në stadium. "Djemtë që janë tani në botën e tifozëve, po ndiejnë efektet e asaj që autoritetet po bëjnë për të siguruar që Kupa e Botës të mbahet pa probleme, përfshirë edhe tifozët rusë", tha 35-vjeçari, i cili kryeson shoqatën e mbështetësve të skuadrës ruse Arsenal Tula. Duke folur për "Reuters", Gorbaçev tha se tifozët anglezë që do të udhëtojnë për në Rusi për Kupën e Botës nuk kanë se pse të frikohen nëse ata sillen mirë. "Nëse tifozët që vijjnë sillen mirë, unë do t'u jap dorën", ka thënë Gorbaçev, i cili tha zbuloi se ka mësuar frëngjishten dhe lexoi veprat e Fjodor Dostojevskit dhe Mikhail Bulgakov duke shërbyer dënimin e tij në burgun Baumettes të Marsej. Ndërkohë, Rusia ka shtuar forcat policore në prag të Kupës së Botës. Në disa raste, tifozëve u është dashur të premtojnë në letër se nuk do të marrin pjesë në sherre. Një ministër thotë se do të ketë polic çdo 20 metra. Tifozët që do të kenë vëmendje të veçantë janë anglezët.



Sergei Gorbaçev

Djemtë që janë tani në botën e tifozëve, po ndiejnë efektet e asaj që autoritetet po bëjnë për të siguruar që Kupa e Botës të mbahet pa probleme, përfshirë edhe tifozët rusë. Nëse tifozët që vijjnë sillen mirë, unë do t'u jap dorën

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të LMP (Gazeta zyrtare nr. 167/2015, 27/16 Tekst i spastruar.) Pëlqimi nga MASH nr. 12-2919/3 të dt. 15.05.2018 dhe pëlqimi i Komunës së Çairit nr. 09-741/4 nga 29.05.2018 Shfk "Jashar Bej Shkupi"-Shkup Çair nxjerr

SHPALLJE PUBLIKE

Për plotësimin e vendeve të punës në kohë të pacaktuar

Një mbajtës të higjienës me orar të plotë në kohë të pacaktuar me arsim fillor me neto rrogë prej 12.000 den. Orari i punës si vijon: Turni i parë prej orës 06:30 deri 14:30; Turni i dytë prej orës 10:30 deri 18:30;

- Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet të përgjithshme në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.
- Të punësuarit kanë drejtë të pushimit vjetor në pajtueshmëri të MK dhe LMP.
- Kandidatët duhet t'i dërgojnë dokumentacionin në vijim:
 - Lutje me biografi të shkurtër
 - dokument për kryerjen e arsimit adekuat
 - certifikatë për shtetësi
- Shpallja zgjatë 5 ditë prej datës së shpalljes.
- Zgjedhja do të bëhet në afat prej 30 ditëve pas skadimit të afatit për lajmërim.
- Dokumentacioni i jokompletuar nuk do të shqyrtohet.
- Dokumentet e duhura të dërgohen në adresën .:, 124 Duqanxhik nr. pn, SHFK "Jashar Bej Shkupi" - Shkup Çair

SHFK "Jashar Bej Shkupi" - Shkup Çair

Me anë të një konferencë të pa parashikuar vetë trajneri ka deklaruar dorëheqjen nga stoli i Real Madridit, pasi vetëm pak ditë me parë fitoi "Champions League" për të tretin vit radhazi. Sipas mediave ai është në kontakt me Federatën Franceze për të marrë në drejtim përfaqësuesen e atij vendi

Trajneri francez, Zinedin Zidane nuk do të jetë më trajneri i Real Madridit, pasi ka dhënë dorëheqjen e menjëhershme nga drejtimi i skuadrës së "Los Blancos", në konferencën e paradites së djeshme. Me anë të një konferencë të pa parashikuar vetë trajneri ka deklaruar dorëheqjen nga stoli i Real Madridit, pasi vetëm pak ditë me parë fitoi "Champions League" për të tretin vit radhazi. Ka qenë pikërisht Zidane që ka shpjeguar largimin nga stoli madrilen, drejtimin e të cilëve e kishte marre dy vite e gjysme më parë, teksa sukseset dhe rekordet e arrira janë të mëdha. Zidane ka dalë përkrah presidentit Florentino Perez, e ka marrë fjalën prej tij, duke komunikuar. "E mora këtë vendim, sepse e dua shumë këtë klub. Mendoj se sot, për mua dhe për të gjithë, është mirë të ndryshoj diçka dhe si trajner të mos vazhdoj sezonin e ardhshëm. Ky është vendimi im, ka njerëz që mund të mendojnë ndryshe, por pas tre vjetësh, është koha për t'u larguar. E shoh qartë atë që duhet të bëj, të ndryshoj më mirë, të mos vazhdoj dhe të bëj gjëra të pakuptimta. Futboll-

ZINEDIN ZIDAN JEP DORËHEQJE TË PA PARASHIKUAR

ISHTE KOHA TË LARGOHEM, LOJTARËVE U DUHET NJË NDRYSHIM



stët e dinë, nuk kam folur drejtpërdrejt me ta, as veç e veç, por stafi ua ka bërë të ditur. Do të flas me të gjithë. Për momentin kam biseduar vetëm me kapitenin Sergio Ramos", u shpreh në fillim Zidane. "Unë mendoj se është koha të largohem. Lojtarëve u duhet një ndryshim. Unë dua t'i falënderoj lojtarët, sepse ata luftojnë në fushë. Ky është një klub shumë i kërkuar. Historia e këtij klubi është shumë e madhe. Çfarë tjetër mund të kërkoj unë? Është koha që të vijë një tjetër trajner dhe të fitojë përsëri. Fitiimi i trofeve për këtë klub është një çështje për të gjithë, jo për një, ose dy njerëz", shtoi më tej Zidane. Ai ka pranuar se ky vendim i tij nuk ka kuptim për shumë persona, po jo edhe për at.

Unë e kam jetuar, por po ju them se kjo është ëndrra e shumë lojtarëve. Gjëja më e bukur është kur presidenti më mori për të luajtur në këtë klub të madh. Largohe si tri herë fitues i 'Champions'-it në rolin e trajnerit, me njëfarë hidhërimi që dështuam në La Liga këtë sezon. Gjëja më e keqe për këtë sezon ishte eliminimi nga Kupa e Mbretit, kundër Leganes.

"Real Madridi më ka dhënë gjithçka, unë do të jem pranë këtij klubi gjatë gjithë jetës time. Ky vendim ndoshta nuk ka kuptim për shumë persona, por jo për mua. Është koha për të bërë një ndryshim, edhe për lojtarët është mirë. Pas tri vitesh, mendoj se është vendimi i duhur. Mbi të gjitha dua të falënderoj tifozët, që na kanë mbështetur gjithmonë. Kam një dashuri e respekt të veçantë për ta. Dëshiroj t'i falënderoj përsëri, për të gjithë mbështetjen tuaj e tyre, edhe kur kemi pasur momente të komplikuar, edhe kur na kanë vërshtëlyer, por kjo është pjesë e këtij klubi", deklaroi tanimë ish-trajneri i Realit, Zinedin Zidane. Në anën tjetër ka folur edhe presidenti i klubit Florentino Perez. "Unë dua t'ju falënderoj për përkushtimin tuaj, pasionin tuaj, dashurinë tuaj dhe gjithçka që keni bërë për Real Madridin këto vite. E vetmja gjë që do të doja të thosha është se do të shihemi së shpejti. Unë nuk kam dyshime se do të ktheheni, por nëse keni nevojë për një pushim, gjithashtu e meritoni atë. Ky është një vendim i papritur për mua, është një ditë e trishtuar. E



Ky është një vendim për të mirën e të gjithëve, ndryshimi është i domosdoshëm për të mbajtur fitoret. Nuk duhet të shkoj përtej kësaj. Tani ndihem mirë. Kjo nuk është një ditë e trishtuar për mua, por një kohë e komplikuar. Unë njoh shumë njerëz këtu dhe kjo nuk do të ndryshojë marrëdhënien. Kujtesa ime më e mirë është kur presidenti Perez më solli këtu për të luajtur, në këtë klub të madh

kam dashur Zidane si një lojtar dhe si trajner. Jam pikëlluar dje, kur e kam dëgjuar këtë vendim të tij. Unë do të doja ta bindja, por e di se si ai është. Kjo është shtëpia dhe familja juaj përgjithmonë. Sinqerisht, nuk ishim të përgatitur për një lajm të tillë", ka thënë Perez.

Ausilio në Angli për mesfushorin Dembele

Drejtori sportiv i Inter Pier Ausilio do të udhëtojë në Londër për të negociuar me Tottenham Hotspur për Moussa Dembele, sipas raporteve. Mesfushori belg do të mbushë 31 vjeç në korrik, dhe është në skuadrën e Roberto Martinez për Kupën e Botës. Ai është përfolur për një transferim te Napoli, por "Corriere dello Sport" raporton se Ausilio është drejt Londrës për të parë nëse mund të arrihet marrëveshja me klubin anglez. Teksa Spars kërkojnë 30 milionë euro, Dembele e ka bërë të qartë se kërkon të largohet nga klubi. Çdo marrëveshje që mund të ndodhë duhet të presë korrikun pasi Interi duhet të rregullojë bilancin e "Fair Play Financiar".



Junajted sërish hidhet në sulm për Bejllin

Megjithëse nuk ka qenë në gjendje të transferonte Geret Bejllin në vitet e fundit, Manchester Junajtedi beson se ky është momenti i duhur për të siguruar yllin e Real Madridit. Në "Old Trafford" janë të vetëdijshëm për pakënaqësinë e Bejllin në Madrid. Ai e ka bërë të qartë se do të negociojë të ardhmen e tij me klubin "Merenegues" për t'u siguruar nëse vlerësohet. Ndërkohë "Djajtë e Kuq" duan ta bindin uellsianin se Junajted është destinacioni i përsosur për të – një klub që do ta kthente në një yll botëror. Siç raporton "Marca", Florentino Perez është më i shqetësuar për Bejllin sesa për Ronaldon, për të cilin janë të bindur se do të rinovojë me "Los Blancos". Trajneri i Manchesterit, Hoze Murinjo e kërkoi Bejllin edhe gjatë vitit të kaluar, por në intervistën e tij me "Marca", lojtari ka thënë se qëndrimi në Madrid ishte prioritet. Edhe klubi nuk ka ndërmend të shesë lojtarin dhe pret që ai të konfirmojë qëndrimin në kryeqytetin spanjoll.



Milinković-Savić i zbulon miqve skuadrën e ardhshme



"Milinković-Savić do të shkojë tek Juventus: mbajeni mend këtë tweet", ka qenë mesazhi të cilin e ka shkruar gazetari serb Milos Markovic dhe ka bërë xhiron e in-

ternetit në ditët e kaluara. Një mesazh që është mbështetur edhe nga e përditshmja italiane "Tuttosport", që ka shkruar se mesfushori i Lacios i ka zbuluar disa miqve të tij se është shumë afër bardhezinjve. Por, pengesa më e madhe për realizimin e këtij operacione janë marrëdhënies aspak të mira mes presidentit Lotito dhe drejtuesve bardhezi. Nëse këto marrëdhënie do të përmirësohen, në operacion mund të përfshihen edhe disa lojtarë të tjerë, si Stefano Sturaro, Rolando Mandragora dhe Rodrigo Bentnakur.

Zhorginjio shumë pranë kalimit te Siti



Napoli zyrtarizoi disa ditë më parë në krye të ekipit trajnerin, Karlo Ançelotti, por pikëpyetjet më të madha ishin për qëndrimin e kapitenit të ekipit, Marek Hamshik. Ndërkohë, projekti i teknikut italian ishte aq bindës, pasi edhe kapiteni bashkë me Mertens kanë konfirmuar qëndrimin, por sipas gjasave Ançelotti ka humbur një

tjetër lojtar të rëndësishëm në vitet e fundit te Napoli. Bëhet fjalë për mesfushorin, Zhorginjio për të cilin thuhet se gjithçka është në fazën e finale drejt transferimit te Manchester Siti. Gjithashtu, bisedimet mes presidentit, De Laurentis dhe drejtuesve të "Qytetarëve" për mesfushorin italo-brazilian janë drejt fundit, pasi akordi mes palëve është arritur. Gjithashtu, në sezonin e ardhshëm, Zhorginjio do të stërvitet nga spanjollit, Pep Guardiola, pasi Napoli ka pranuar ofertën prej 50 milionë eurosh. Mesfushori pritet të firmosë dhe një kontratë 5-vjeçare, nga e cila do të përfitojë 20 milionë euro në sezon.

DASHI 21. mars - 20. prill

Në dashuri do të shfaqni shumë pretendime dhe kjo gjë, për shkak se po mundohuni të lini pas krahëve të gjitha zhgënjimet me të cilat jeni përballur në të kaluarën. Gjithsesi, mundohuni të mos e vini shumë nën presion, partnerin/en tuaj. Në vendin e punës parashikohen të reja të rëndësishme.

DEMI 21. prill - 21. maj

Kur jeni të përhumbur në mendime, shpesh prireni të izoloheni, por kjo gjë mund t'iu ndalojë që të hapeni më shumë me personat që ju rrethojnë. Kësaj do ju mohohet mundësia për të marrë sugjerime me vlerë prej tyre. Mos e humbni një mundësi të mirë që do ju ofrohet, për të bërë njohje të reja.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Parashikimet e yjeve flasin për një ditë të rëndësishme, e cila iu projekton drejt një vendi intrigues, sidomos sa i takon fushës së ndjenjave. Do të merrni surpriza të bukura, lidhur me një projekt i cili deri më tani nuk iu bindte.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Jini më të komunikueshëm dhe më të gatshëm për të bashkëpunuar në vendin e punës, kjo pasi do të jetë e rëndësishme për ti dhënë jetë një projekti të ri. Sa i takon dashurisë, kjo e enjte nuk do të jetë shumë e favorshme.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Do të jeni të shqetësuar për shkak të një sërë çështjesh lidhur me karrierën tuaj profesionale. Mos e humbni durimin lidhur me strategjitë tuaja, por analizojini me më shumë kujdes, duke ndjekur udhëzimet e bashkëpunëtorëve tuaj. Në mënyrë parashikohen takime interesante.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Në lidhjen në çift do të jeni shumë xheloz dhe kjo për shkak të disa përgjigjeve që po vonojnë të vijnë. Gjithsesi kjo gjë nuk duhet marrë shumë përpjekur. Megjithatë kjo ditë do të hapë mundësi shumë të mira para jush.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Do të jeni mjaft të angazhuar në realizimin e një projekti të ri profesional, i cili do ju shohë të përkushtuar maksimalisht. Mos ngurroni të shfaqni autoritetin tuaj.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Mundohuni të mos jeni shumë kritikë ose mendjemadh, pasi në të kundërt rrezikoni të krijoni shumë armiq përreth. Sfidat nuk do ju trembin, por duhet të rrethoheni nga njerëz pozitiv për të kapërcyer pengesat.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Gjatë kësaj të enjteje, mund të tërhiqni vëmendjen e një personi me ndikim, i cili do të vlerësojë cilësitë tuaja. Mos u tregoni të rezervuar në dashuri, si dhe tregoni kujdes me fjalët.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Do të jeni të detyruar të punoni më shumë, për të rregulluar gabimet e kryera nga të tjerët dhe kjo gjë ju shkakton tension të madh. Gjithsesi mundohuni të mos përfshihen nga ankthi sa i takon situatave familjare, apo atyre të dashurisë.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Përmbillet një muaj i cili ju sugjeron që të veproni me më shumë qetësi dhe përqendrim në vendin e punës, sidomos nëse keni nisur negociatat të rëndësishme. Horoskopi i kësaj dite ju fton që të menaxhoni më mirë kursimet tuaja.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Kjo do të jetë një periudhë e shkëlqyer për sektorin profesional, duke arritur të realizoni një sërë projektesh dhe idesh që i mbani në sirtar prej kohës. Në dashuri, këshillohet të mos jeni shumë impulsiv.

Mensur Mamuti	ITHTAR I MATERIALIZMIT	PJESA E NJË TËRËSIE	QYTET NË ITALI	VENDSHËRIM NË ADRIATIK (MALI I ZI)	LATINISHT (SHKURT.)	UDHËPËRSHKRIM	NOKAUT (SHKURT.)	MAGJISTËR	OKSIGJENI	E BËN TË FORTË SI GUR	KËNGËTARI DËVID LI	TINGULL- IMITIM
SHIH FOTON												
LLOJ KROKODILI									VRAPUESI KOREAN, TAÏKA ARI (SIMBOLI)			
QË LIDHET ME TEMA TË ÇAKTUARA								AUTOMOBIL QYTET NË HOLANDË				
SHKRIMTARI ZOLA					AZOTI SHTET NË AFRIKË		BASHKËLUFËTËTARI I MUSALIT, SIPAS BIBLES, BEN SHOK MIK				METRI MAKINË SHTYPTI	
FAMË NAM (SHQ.)									HYJNESHË HITTE PROVAJDERI GREK I TELEKOMUNIKA- CIONIT			
LUMË NË NIGËRI				MINERALI KARBONIT (CaCO ₃) THIRRJE TELEFONIKE								
ASTATI			MAL NË TURQI PRIJËSI I FASHISTËVE							SHKURTESA PËR "NUMËR, NR" FILOZOF GREK		
LITRI		QYTET NË SPANJË NATRIUMI						SHKRIMTAR I VJETËR GREK AGJENCIA E SHTYPTIT ITALIAN				
GADISHULL NË AZI									ENERGY TRANS- FER EQUITY REVOLUCIO- NARI JAPONËZ, HIROBUMI			
QYTETI BRAZILIAN, PAULO								PETRO LUARASI				TËRËSI E FABRIKAVE, KOMBINATEVE
TEMPERATURA		50 ROMAK AUTOMJET TRANSPORTI						SHENJË KOMUNIKACIONI				
KOHA	KLUBI FUTBOLLISTIK KËNGËTARI ARDIT							BANOR IAONISË			NORVEGJIA QELI ZË NERVORE	
GUJETI									BASHKIM QELIZASH			
SHPËRBLIM FILMIK										EUROPIUMI		
NËSIA BAZË E INFORMACIONIT (INFORMATIKE)										UNITED STATES POHIM ÇEK		
PJESËMARRJE NË FILM VIT, MOT (VJET.)								TORONTO	VEPRIMTARI ARTISTIKE EMIL ZATOPEK			
S								ZË MASHKULLI				
AJËR (ANG. ORIGLI)								MODIFIKIMI ALOTROPIK I OKSIGJENIT				



ZGJIDHJET: MERILIN MONRO, ALIGATOR, GON, TEMATIK, AUTO, EMIL, N, HUR, M, RENOMEJA, OLA, INI, ARAGONIT, AT, ARARAT, NO, L, ALORA, EZOP, INDOKINA, ETE, SAO, NINI, T, L, STOPI, KE, AON, N, GJAH, IND, EMI, EU, BIT, US, ROL, ART, SENE, TENOR, AIR, OZONI.

shumë i lehtë **Sudoku** *mesatar*

					1													3
4		2			6	9			1			4	8				1	
8			4	9							6	9	2			8	4	6
	1					5							9	8		1		
2		6	1		7	3			4					1	6		4	
		4						6							2		7	1
1				5	8						3				1	4		
9		5			4	8			2			5	6	8			1	4
					2												3	7

Shumë i lehtë: 369271458, 452836971, 871495236, 713648529, 296157384, 584923167, 127589643, 935764812, 648312795. Mesatar: 617592834, 485631297, 923784561, 798415623, 251367489, 364928715, 872143956, 536879142, 149256378.

Çfarë i ndodh makinës kur parkoni gabim



Të parkosh makinën është një shqetësim i përditshëm për të gjithë. Por, kur parkon gabim ka edhe pasoja. Një gjë e tillë ka ndodhur pranë aeroportit të Manchesterit në Angli. Qytetarët në atë zonë u shokuan kur panë makinat se ishin vandalizuar. Ato ishin lyer me bojë të bardhë kur shkruhej "nuk lejohet parkimi" dhe u ishin çarë gomat. Policia ka nisur hetimet për këtë ngjarje. Disa e cilësuan të papranueshme këtë sjellje vandale. Muajin e fundit, parkimi ka qenë një çështje e diskutueshme në zonat e banuara përreth aeroportit të Manchesterit. Shumë vetë janë ankuar se makinat qëndrojnë të parkuara për ditë me radhë apo edhe javë, ndërsa pronarët e tyre shkojnë me pushime. Kjo gjë mesa duket ka shkaktuar irritimin e banorëve të tjerë, të cilët lyejnë me bojë automjetet dhe u çanë gomat.

Pas 19 vitesh martesë zbulon se gruaja ishte burrë!

Një 64-vjeçar nga Belgjika ka zbuluar se gruaja e tij është një mashkull. Belgu me emrin Jan u martua në vitin 1993 me Monikën, një tajlandeze atëherë 31 vjeçe. Në momentin e martesës, zyra e emigracionit nuk qe e bindur për rregullsinë e dokumenteve të gruas, por në fund ajo u pranua të qëndrojë në Belgjikë, shkruan gazeta "Het Nieuwsblad". Por Monika ia kishte fshehur të shoqit me kujdes ndryshimin e seksit: përveçse e mbështeste që të mos bënte fëmijë "sepse ai kishte dy nga martesat e parë", "ajo" shtirej se kishte menstruacione, duke u sjellë si një femër e zakonshme. Jeta martesore dukej si ajo e një çifti normal, derisa Monika la punën dhe filloi të shoqërohej me persona të rinj, kryesisht femra. Nga ky fakt dhe nga disa zëra që qarkullonin



gjithandej, Jan zbuloi të vërtetën për gruan e tij: ajo kishte ndryshuar seks pak vjet përpara se të martoheshin.

Asnjëherë mos e vendosni portofolin në xhepin e pasim. Ja arsyeja



Shumë njerëz që e vendosin kuletën në xhepin e pasmë të tyre por mjekët japin edhe arsye të tjera përse nuk duhet të mbahet kuletë në xhepin mbrapa. Sipas mjekëve kuletë nuk është bërë të futet në xhepin prapa për shkak se krijon një çrregullim të legenit dhe të ijeve. Askush nuk duhet të mbajë kuletën në xhepin e pasmë, jo se mund t'ju vidhet, por për shkak se është shumë keq për shpinën tuaj, dhe qëndrimin tuaj kur jeni ulur. "Kur uleni mbi kuletën tuaj krijon një asimetri dhe çrregullim

që shtrembëron legenin dhe ijet", ka thënë Dr. Arnie Angrist për Huffington Post. Kjo mund të çojë në disa çrregullime në trup, përfshirë këtu dhimbje të përkohshme, degjenerim, agjitacioni i nervit të pasmë që mund të shkaktojë parehati. Ajo mund të shkaktojë dhimbje edhe në këmbë. "Madje edhe nëse vozitni për 30 minuta kur jeni duke vozitur mund të shkaktojë dhimbje dhe parehati të madhe", ka thënë Dr. Mathew Ullom. Për këtë arsye preferohet që kuletë të vendoset në xhepin e përparmë.



50 vite neglizhencë, heq nga trupi 15 kg tumor

Kirurgët kanë kaluar 10 orë në sallën e operacionit për të hequr 15 kg nga qafa e një 64-vjeçari, i cili kishte afro 50 vite pa e kurrë kuruar. Zhao Xingfu, nga Kina, ka treguar se masa tumoriale, e njohur si lipoma, i ishte shfaqur 47-vite më parë në madhësinë e një veze. E në moshën 17-vjeçare, Xingfu e injoroi këtë masë që po rritej në qafën e tij pasi nuk ndjente dhimbje, por edhe sepse nuk mund të përballonte kurën. Por pasi pesha e masës tumoriale, i ndikuar edhe nga moshën e thyer, i ka krijuar vështirësi në ecje 64-vjeçarit. Ka qenë djali i këtij të fundit që ka kontaktuar mjekët që kanë marrë përsipër ndërhyrjen sa të vështirë, po aq edhe të rrallë.



794 - Karli i Madh hap sinodin e përgjithshëm në Frankfurt.
1485 - Matiasi i Hungarisë merr Vjenën nga Fredriku III.
1641 - Franca dhe Portugalia nënshkruajnë marrëveshje kundër Spanjës.
1774 - Qeveria britanike urdhëron mbylljen e Limanit të Bostonit.
1796 - Tenisi shpallet shteti i 16 i SHBA.
1941 - Trupat britanike okupojnë Bagdadin.
1946 - Ekzekutohet Ion Antonescu.
1948 - Izraeli dhe Arabët merren vesh për armëpushim.
1958 - Sharl de Gol zgjidhet Kryeministër i Francës.
1963 - Mbreti Victor Emmanuel III i Italisë shpallet Perandor i Etiopisë.
1969 - Ndalohej reklamimi i duhanit në TV dhe radiot kanadeze.
2009 - Aeroplani Air France 447 rrëzohet në Oqeanin Atlantik larg prej bregut brazilian në fluturimin Rio de Zhenairo për në Paris ku vdesin të gjithë 228 pasagjerët dhe personeli.

KALENDARI HISTORIK 1 QERSHOR



Janë të shumta gabimet që bëhen në përditshmërinë tonë, teksa kujdesemi për fytyrën. Por sipas dermatologëve një ndër gabimet më trashanike është përdorimi i peshqirit për të tharë fytyrën. Fillimisht, peshqiri për fytyrën nuk duhet të jetë i njëjtë me atë të trupit. Dermatologët shprehen se përdorimi i peshqirit, mund të përhapë baktere në lëkurën e sapo pastruar, duke shkaktuar puçrra në fytyrë. Ndërkohë që, fytyra e lagur vepron si sfungjer dhe do të përthithë më shpejt të gjitha produktet që do të vendosni pas dushit. Ndaj lajeni fytyrën me ujë të rrjedhshëm, e lejoni që të marrë frymë. Më pas mund të aplikoni të gjitha produktet që përdorni në përditshmërinë tuaj.

PËRSE MARTOHEN GRATË?

Përse martohen gratë?
Për mungesë përvoje!
Përse ndahen?
Për mungesë durimi!
Përse martohen prapë?
Për mungesë kujtese!



Shkruaj kur je i pirë.
Redaktoje kur je esëll.
(Ernest Hemingueji)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS